



Standarde të Hapura për Praktikën e Ruajtjes


Versioni 3.0 / Prill 2013



Partneriteti për Masat e Ruajtjes (PMR) është një konsorcium i organizatave të ruajtjes, misioni i të cilave është të avancojnë praktikën e ruajtjes duke zhvilluar, testuar dhe promovuar parimet dhe mjetet për të vlerësuar dhe përmirësuar në mënyrë të besueshme efektivitetin e veprimeve të ruajtjes.



Standarde të Hapura për Praktikën e Ruajtjes




Versioni 3.0
Prill 2013

Partneriteti për Masat e Ruajtjes *Standarde të Hapura për Praktikën e Ruajtjes*

Versioni 3.0

Zhvilluar nga:

Partneriteti për Masat e Ruajtjes





Publikimi “Standarde të Hapura për Praktikën e Ruajtjes” i zhvilluar prej [the Conservation Measures Partnership](#) është licensuar në kuadër të [Creative Commons Attribution-ShareAlike 3.0 Unported License](#).

Publikimi “Standarde të Hapura për Praktikën e Ruajtjes”, Versioni 3.0, është produkt i inputeve, testimave në terren dhe diskutimeve midis anëtarëve të Partneritetit për Masat e Ruajtjes si dhe të partnerëve të tyre respektivë.

Të kuptojmë “Licensën e Krijimtarisë së Përbashkët”: Në kuadër të licensës për krijimtari të përbashkët, një person mund të marrë Standardet e Hapura dhe ti përshtasë ose modifikojë ato sipas situatave specifike, duke siguruar a) referimin e burimit original Standarde të Hapura (por në mënyrë të tillë që të sugjerojë se LKP pranon këtë material të prejardhur), dhe b) të publikojë këtë material të prejardhur/ të modifikuar nën një licensë të ngjashme me atë të krijimtarisë së përbashkët. Gjithashtu personi mund të kontribuojë formalisht me modifikimet e tij nëpërmjet grupit udhëheqës të LKP, i cili konsideron përfshirjen e këtyre modifikimeve në një version të ri zyrtar të Standardeve të Hapura. Ky proces siguron që Standardet të evoluojnë vazhdimisht përmes inputit të një game të gjerë praktikuesish, të jenë të përshtatshme ndaj nevojave të organizatave, dhe sërish të sigurojnë një standard global të menaxhuar me kujdes për punën në fushën e ruajtjes.

Çfarë është Partneriteti për Masat e Ruajtjes (PMR)? PMR është një konsortium i përbërë nga organizata të cilat punojnë në fushën e ruajtjes dhe që kanë mision të avancojnë praktikën e ruajtjes përmes zhvillimit, testimit dhe promovimit të parimeve dhe mjeteve, që në mënyrë të besueshme të vlerësojnë dhe përmirësojnë efektivitetin e veprimtarive në fushën e ruajtjes. Çdo organizatë pjesë e PMR ka si qëllim parësor ruajtjen e biodiversitetit, fokusohet në arritjen e rezultateve të prekshme në fushën e ruajtjes, dhe punon për të përmirësuar përfaqësimin në hartimin, menaxhimin dhe vlerësimin e projekteve.

Anëtarët aktualë të LKR-së: Fondacioni Afrikan i Jetës së Egër, CATIE (Zonat e Mbrojtura dhe Programi i Korridoreve Biologjike), Ruajtja Ndërkombëtare, Fondacioni David dhe Lucile Packard, Mbrojtësit e Jetës së Egër, Përgjithmonë Kosta Rika, Fondacioni i Suksesit, Fondacioni Gordon dhe Betty Moore, Fondacioni John D. dhe Catherine T. MacArthur, Fondacioni Keith Campbell për Mjedisin, Shkolla Latine e Amerikës për Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura, Fondacioni Bimirës Leona M. dhe Harry B. Helmsley, Fondacioni Margaret A. Cargill, Shoqata Kombëtare Audubon, Fondi Kombëtar i Peshkut dhe Jetës së Egër, Aleanca e Pyjeve Tropikalë, Ruajtja e Natyrës, Shërbimi i Peshkut dhe Jetës së Egër në SHBA (Jeta e Egër pa Kufij), Fondacioni Familja Walton, Rrjeti i Ruajtjes së Jetës së Egër, Shoqata e Ruajtjes së Jetës së Egër dhe WWF.

Rishikime dhe Përditësime: Partneriteti për Masat e Ruajtjes ka aprovuar këtë dokument. Megjithatë, si pjesë e procesit të menaxhimit adaptiv, anëtarët e PMR do të vazhdojnë rishikimin dhe përmirësimin e tij në kohë. Për versionet e përditësuar, materialet udhëzuese në mbështetje të Standardeve si dhe për informacion shtesë rreth PMR, vizitoni faqen tonë në: www.conservationmeasures.org

Ne inkurajojmë nga çdokush që përdor këtë version të Standardeve të Hapura të na dërgojë mendimet e tij
in lutem na dërgojë komentet tuaja në: CMInfo@conservationmeasures.org

Përmbajtja

Hyrje	1
Zanafilla dhe Evolucioni i <i>Standardeve të Hapura</i>	4
Të përdorim <i>Standardet e Hapura</i>	5
Parimet e Përgjithshme për Zbatimin e Standardeve të Hapura.....	6
1. Konceptimi	10
1A. Përcaktoni qëllimin e planifikimit dhe ekipin e projektit.....	11
1B. Përcaktoni fushëveprimin, vizionin dhe targetet e ruajtjes.....	12
1C. Identifikoni Kërcënimet Kritike.....	14
1D. Analizoni rrethanat e ruajtjes	16
2. Planifikoni aktivitetet tuaja dhe Monitorimin	21
2A. Hartoni një Plan Formal Veprimi: Qëllimet, Strategjitë, Supozimet dhe Objektivat	22
2B. Hartoni një Plan Formal Monitorimi.....	30
2C. Hartoni një Plan Operacional	34
3. Zbatoni Aktivitetet dhe Monitorimi	35
3A. Hartoni një plan pune të detajuar aftashkurtër dhe një plan kohor.....	35
3B. Zhvilloni dhe Përmirësoni Buxhetin e Projektit tuaj.....	37
3C. Zbatoni planin tuaj.....	37
4. Analizoni, Përdorni, Përshtasni	38
4A. Përgatisni të dhënat tuaja për analizë.....	38
4B. Analizoni Rezultatet	39
4C. Përshtasni planin tuaj strategjik	40
5. Ruajtja dhe ndarja e të nxënësve	41
5A. Dokumentoni çfarë mësoni	41
5B. Ndani atë çfarë nxëni	41
5C. Krijoni një mjedis për të mësuar.....	43
Mbyllni qarkun	43
Shtojca 1. Fjalorth	45
Shtojca 2. Përkufizime dhe kritere për termat kyçe	50
Shtojca 3. Përmbledhje e Standardeve të Praktikës dhe Produkteve	52
Shtojca 4. Shembull i aplikimit të <i>Standardeve të Hapura</i> në një projekt tematik	54

Hyrje

Komuniteti i ruajtjes së biodiversitetit po trajton probleme mjedisore të mëdha, komplekse dhe urgjente ku piketat janë të larta. Njerëzit në mbarë botën mbështeten tek ne; ata na besojnë, ata punojnë së bashku me ne dhe japin burime të rëndësishme që të veprojmë në mënyrë efektive për të shpëtuar planetin. Por ne kemi një problem - ne nuk kemi një sistem plotësisht funksional për të vlerësuar efektivitetin e veprimeve tona. Ndërkohë që është bërë një përparim frymëzues, vetëm pak organizata që punojnë në fushën e ruajtjes mund të thonë vazhdimisht se çfarë po funksionon, çfarë mund të përmirësohet dhe cilat qasje duhet të ndryshohen.

Pa matje më rigorozë të efektivitetit dhe pa regjistrim të disiplinuar të përpjekjeve tona, si do ta dimë nëse po përparojmë me shpejtësinë e nevojshme për të arritur qëllimet tona të ruajtjes? Si do të bëhemi më efikas? Si do të mësojmë nga njëri-tjetri? Dhe si do të jemi në gjendje të tregojmë arritjet tona në mënyrë që të ndërtojmë vullnetin publik dhe politik dhe kështu të zgjerojmë burimet për të përmbushur me të vërtetë sfidat me të cilat përballemi?

Komuniteti i ruajtjes ka nevojë urgjente për sisteme të fuqishme për planifikimin e projekteve që bazohen në rezultatet e arritura, menaxhimin dhe monitorimin e tyre. Për më tepër, komuniteti duhet të praktikojë menaxhimin adaptiv bazuar në vlerësimin e vazhdueshëm të rezultateve dhe të përdorë këtë informacion për të mësuar nga njëri-tjetri rreth asaj çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon. Bashkarisht, kjo qasje do të ndihmojë komunitetin e ruajtjes të ndërtojë vullnetin publik për të zgjeruar burimet në dispozicion.

Për të përmbushur këto nevoja, Partneriteti për Masat e Ruajtjes (PMR) ka punuar gjatë dekadës së fundit për të kombinuar parimet dhe praktikën më të mira të menaxhimit adaptiv dhe menaxhimit të bazuar në rezultatet e arritura nga ruajtja, me fushat e tjera, për të krijuar *Standardet e Hapura për Praktikën e Ruajtjes (Standardet e Hapura ose Standardet, prej këtu e në vijim)*¹. *Standardet e hapura* bashkojnë koncepte, qasje dhe terminologji të përbashkëta gjatë hartimit të projekteve të ruajtjes, menaxhimit dhe monitorimit të tyre, me qëllim që të ndihmojnë praktikuesit të përmirësojnë praktikën e ruajtjes. Ne kemi zhvilluar këto *Standarde të Hapura* në mënyrë që ato të mund të aplikohen në çdo shkallë gjeografike, kohore ose programi etj.

PMR është e përkushtuar ndaj vizionit që përpjekjet globale të ruajtjes do të jenë më efektive dhe efektive në momentin që ne rrisim dijen tonë mbi mënyrën se si të përdorim ose të shumëfishojmë atë që funksionon, dhe të mos përsërisim atë që nuk bazohet në matjen e

¹ Ne përdorim termin "*Standarde të Hapura*" duke ju referuar lëvizjes Burime të hapura/Krijimtari e përbashkët për të nënkuptuar standardet që zhvillohen përmes bashkëpunimit publik, lirisht në dispozicion të të gjithëve dhe jo pronë e ndokujt apo ndonjë organizate. Për më shumë informacion rreth kushteve të Licencës së Krijimtarisë së Përbashkët, shiko kutinë në fillim të këtij dokumenti.

besueshme të efektivitetit tonë dhe në shpërndarjen publike të mësimave të nxëna. Për të realizuar këtë vizion, organizatat anëtare synojnë²:

- Të caktojmë rezultatet e dëshiruara si rezultate që vijnë nga ruajtja, dhe jo si rezultate të aksioneve për ruajtjen. Vetëm të përpiqemi nuk është e mjaftueshme për të arritur suksesin. Ne do të specifikojmë rezultatet e dëshiruara dhe të matshme si për periudhën afatshkurtër (p.sh. fondet e ngritura, ligjet e miratuara) ashtu edhe për atë afatgjatë (p.sh. zvogëlimi i kërcënimit, përmirësimi i statusit të ruajtjes së specieve).
- Të përcaktojmë se si përpjekjet tona do të na udhëheqin drejt rezultateve të dëshiruara. Ashtu si një shkencëtar pohon një hipotezë të qartë përpara se të kryejë një eksperiment për ta testuar atë, ne do të artikulojmë dhe do t'i ndajmë "teoritë e ndryshimit" që do të vijnë nga veprimet tona përpara se t'i zbatojmë këto veprime.
- Të regjistrojmë progresin tonë drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara. Ne nuk do të presim deri në fund të një veprimi për ta vlerësuar atë, por do të vlerësojmë sistematikisht treguesit afatshkurtër dhe afatgjatë për të matur efektivitetin e veprimeve tona, duke investuar në masa të përshtatshme për rreziqet që menaxhojmë.
- Të përshtasim strategjitë tona duke u bazuar tek mësimet e nxëna. Të masim vetëm efektivitetin nuk rregullon gjë. Ne do të përdorim të dhënat dhe analizat tona për të na udhëhequr drejt realizimit të gjërave që funksionojnë dhe më pak drejt atyre që nuk funksionojnë.
- Të ndajmë rezultatet tona me respekt, sinqeritet dhe transparencë për të lehtësuar të nxënin. Ne nuk do të kemi sukses çdo herë, por nëse jemi të ndershëm në vlerësimet e përpjekjeve tona, do të mësojmë çdo herë. Dhe nëse i ndajmë vlerësimet tona hapta me njëri-tjetrin dhe me publikun, do të rrisim të nxënin dhe transparencën dhe do të avancojmë punën e komunitetit të ruajtjes së biodiversitetit në tërësi.

Standardet e Hapura janë organizuar në një cikël me pesë hapa për menaxhimin e projekteve:

HAPI 1	Konceptimi i vizionit dhe kontekstit të projektit
HAPI 2	Planifikimi i aktiviteteve dhe monitorimi
HAPI 3	Zbatimi i aktiviteteve dhe monitorimi
HAPI 4	Analiza e të dhënave, përdorimi i rezultateve, dhe përshtatja
HAPI 5	Ruajtja dhe ndarja e të nxënit.

Standardet e hapura kanë për qëllim të përshkruajnë procesin e përgjithshëm dhe të nevojshëm për zbatimin e suksesshëm të projekteve të ruajtjes³. *Standardet* nuk janë një recetë që duhet ndjekur saktësisht. Përkundrazi, ato janë menduar kryesisht për të udhëhequr vendimet *programatike* në menaxhimin e projektit (p.sh. përcaktimin e ndërhyrjeve më të mira për suksesin e ruajtjes). Gjithashtu, ato nuk janë të hartuara për të adresuar plotësisht proceset

² Deklaratën e dakortësimit të plotë të PMR-së nga Samiti i Masave në vitin 2010 e gjeni në www.conservationmeasures.org.

³ Të gjitha përpjekjet e ruajtjes në çdo shkallë mund të përshkruhen në mënyrë eksplicite ose implicite si "projekte" - një sërë veprimesh të ndërmarra për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara. Në këtë dokument, ne përdorim termin "projekt" për të përfaqësuar projektet dhe grupet e projekteve (p.sh. "programet") në të gjitha shkallët.

administrative dhe funksionet që lidhen, për shembull, me buxhetet, kontratat dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Ne presim që këto *Standarde* të përdoren kryesisht kur të jetë e qartë se ku ose në çfarë teme do të punojë një ekip dhe se çfarë ai dëshiron të ruajë. Mjetet plotësuese do të ndihmojnë projektet në prioritizimin gjeografik. *Standardet e hapura* nuk kanë për qëllim të konkurrojnë me këto mjete. Pasi të jetë vendosur se ku dhe me çfarë do të punohet, *Standardet e Hapura* ofrojnë një kornizë për të arritur ruajtjen efektive të këtyre prioriteteve - qofshin ato zona lokale, rrjetëzime zonash, peisazhesh, ekosistemes, speciesth në zonën e tyre të shtrirjes, ose politika kombëtare apo globale dhe çështje tematike si tregjet.

Këto *Standarde të Hapura* janë hartuar për t'iu siguruar kolegëve të organizatave anwtare të PMR - dhe në të gjithë fushën e ruajtjes - një udhërrëfyes të qartë për t'i ndihmuar ata të rrisin maksimum efikasitetin e projekteve të tyre. Përveç kësaj, këto standarde ndihmojnë për të sqaruar atë që duhet të bëjmë për të arritur menaxhim cilësor të projekteve, duke siguruar kështu një bazë transparente për një qasje të strukturuar në vlerësimin (si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm) e veprimve tona. Së fundi, shpresojmë që këto standarde do të promovojnë dhe lehtësojnë bashkëpunim më të madh midis organizatave të ruajtjes - një përbërës thelbësor nëse duam të jemi të suksesshëm në arritjen e qëllimeve dhe objektivave tona.

Ne inkurajojmë nga çdokush që përdor këtë version të *Standardeve të Hapura* të na dërgojë mendimet e tij – ju lutem na dërgon komentet tuaja në: CMPIinfo@conservationmeasures.org

Zanafilla dhe Evolucioni i Standardeve të Hapura

Kutia 1. Çfarë sjell të re Versioni 3.0?

Versioni 3.0 reflekton inputin kolektiv dhe përpjekjet bashkëpunuese të anëtarëve dhe partnerëve të PMR-së të cilët kanë aplikuar *Standardet e Hapura*, dhe kanë njohuri për mënyrën se si këto standarde mund të forcohen. Pikat kryesore përfshijnë:

- Hapi 1 dhe 2 janë më të detajuar, duke reflektuar një input më të gjerë të anëtarësisë së PMR-së dhe eksperiencës së tyre teknike.
- Janë përfshirë targetet për mirëqenien e njerëzimit, me sqarimet përkatëse për lidhjen e tyre me strategjinë e ruajtjes dhe targeted.
- Adresohen në mënyrë të qartë ndryshimet klimatike, me sugjerime se si projektet mund të jenë më proaktive kundrejt adaptimeve klimatike.
- Ka një theksim më të madh në strategjinë e zhvillimit dhe procesin e zgjedhjes, një hap kyç në menaxhimin e projekteve të ruajtjes.
- Përpunohet më shumë nevoja për analizën e grupeve të interesit dhe se si të adresohen interesat primarë.
- Qartësohet përdorimi i *Standardeve të Hapura* për projektet tematike dhe për ato për të cilat vendndodhja nuk është e përcaktuar.

Standardet e Hapura për Praktikën e Ruajtjes janë produkt i punës bashkëpunuese të Partneritetit për Masat e Ruajtjes. Si pikënisje, anëtarët e PMR-së përdorën rezultatet e iniciativës për Matjen e Ndikimit të Ruajtjes (MNR)⁴, një studim i vitit 2002 i cili shqyrtoi përvojat e fituara në shtatë fusha - ruajtja, shëndeti publik, planifikimi familjar, zhvillimi ndërkombëtar, shërbimet sociale, arsimi dhe biznesi – për të përcaktuar konceptet e përbashkëta dhe qasjet në projektimin, menaxhimin dhe monitorimin e projekteve të mira. Gjetjet e MNR janë përpiluar në formën e një sërë parimesh për menaxhimin e ciklit të një projekti /menaxhimin adaptiv. Duke u mbështetur në këto rezultate, organizatat anëtare të PMR-së kontribuan me eksperiencën e tyre në zbatimin e projektit për të përmirësuar *Standardet e Hapura* dhe për t'i përqëndruar ato më shumë në ruajtjen e biodiversitetit.

Shumë organizata anëtare të PMR-së kanë punuar shumë për ti bërë *Standardet e Hapura* funksionale, dhe përpjekjet e tyre kanë qenë një forcë shtytëse për të ndihmuar që *Standardet* të bëhen një praktikë e përbashkët dhe e pranuar brenda komunitetit të ruajtjes. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik që ka përfshirë zhvillimin e standardeve specifike për një organizatë të cilat derivojnë në *Standardet e Hapura* të PMR-së, zhvillimin e materialeve udhëzuese më të detajuara për çdo hap, trajnimin e ekipeve të ndryshme që punojnë në projekte anembanë globit për elementë të ndryshëm të *Standardeve*, dhe zbatimin e standardeve nga këto ekipe. Për më tepër, Rrjeti i Mentorëve të Ruajtjes (ÇNet sipas emrit në anglisht) dhe franshizat e tij rajonale, gjithnjë e më shumë po shërbejnë si një mekanizëm për të promovuar dhe përmirësuar *Standardet e Hapura* në nivel global. Aplikimi në shkallë të gjerë i *Standardeve të Hapura* i ka dhënë PMR-së reagime dhe sugjerime të dobishme për përmirësim.

Standardet e Hapura kanë shërbyer gjithashtu si kornizë për zhvillimin e programit Miradi – një softuer për menaxhimin adaptiv të projekteve (Miradi do të thotë "projekt" në gjuhën Suahili). Shumë nga figurat në këtë dokument janë gjeneruar nga Miradi. Softueri i udhëheq praktikuesit përmes hapave të ndryshëm të *Standardeve të Hapura*. Për shembull, softueri u ofron ekipeve të

⁴ Iniciativa e MNR-së u krye nga Fondacionet e Suksesit (FOS) në bashkëpunim me Shoqatën e Ruajtjes së Jetës së Egër (WCS) dhe Ruajtja Ndërkombëtare (CI), dhe u financua nga Fondacioni Gordon dhe Betty Moore.

projekteve një mjet për të vizualizuar dhe dokumentuar: atë që ata duan të ruajnë; cilat kërcënime dhe mundësi po ndikojnë në grupet e tyre të synuara të ruajtjes; cilat kërcënime kanë domethënie më të madhe; si besohet se ndikojnë veprimet e tyre në situatën në zonën ku operojnë; dhe se si do të bëjnë të zbatueshëm planin e tyre strategjik nëpërmjet një plani pune dhe një buxheti. Vullnetarë të ndryshëm kanë përkthyer tashmë Miradin në disa gjuhë, dhe përkthime të tjera janë duke u kryer. Produktet më të fundit përfshijnë një faqe interneti "dashboard" për të paraqitur të dhëna të nivelit të lartë nga Miradi, dhe një version në internet i Miradit që do të lehtësojë ndarjen e më shumë skedarëve të ngjashëm dhe, në afat më të gjatë, do të lejojë futjen online të të dhënave dhe manipulimin e skedarëve. Shikoni www.Miradi.org për më shumë detaje.

Prej publikimit të versionit 2.0 në vitin 2007, PMR ka ndihmuar në organizimin e dy takimeve të "Samitit të Masave", duke bashkuar një komunitet më të gjerë të praktikuesëve të organizatave të interesuara për masat e ruajtjes dhe menaxhimit adaptiv. PMR gjithashtu ka zgjeruar anëtarësimin e saj duke përfshirë OJQ, donatorë dhe programe qeveritare. Rrjedhimisht, një eksperiencë më e gjerë kolektive informon për evoluimin e vazhdueshëm të *Standardeve të Hapura*.

Të përdorim *Standardet e Hapura*

Përdorimi i *Standardeve të Hapura* për të përmirësuar praktikën e ruajtjes është pjesërisht shkencë dhe pjesërisht e art. Ajo kërkon disa aftësi dhe përvojë për ti marrë këto parime shumë të rregullta dhe të strukturuar dhe për ti zbatuar ato me mjeshtëri në situatat reale nëpër botë. Megjithatë, çdo ekip përfiton nga përpjekja për t'i ndjekur ato dhe, me kalimin e kohës dhe me praktikë, ekipet do të bëhen më të aftë si në artin ashtu dhe në shkencën e zbatimit të *Standardeve të Hapura*.


Për secilin nga pesë hapat e ciklit të menaxhimit të projekteve sipas *Standardeve të Hapura* (Figura 1), ky dokument jep një përshkrim të shkurtër të standardeve të praktikës (nën-hapat) dhe rezultatet e pritura për këtë praktikë (shiko [Shtojcën 3](#)). Numrat tregojnë hapat dhe nën-hapat, dhe pikat me diamant (♦) tregojnë rezultatet. Natyrisht, jo të gjitha standardet apo rezultatet janë të përshtatshme për të gjitha kushtet dhe për të gjitha projektet, prandaj ju duhet ti përshtasni sipas nevojës.

Edhe pse ne i paraqesim *Standardet e Hapura* si një seri hapash ose faza të njëpasnjëshme, ky proces rrallë përdoret në mënyrë lineare nga fillimi në fund, pasi zakonisht është një përafrim i papërpunuar i serive më të ndërlikuara përmes së cilës kalon një projekt.

Procesi i paraqitur në këtë dokument mund të duket i ndërlikuar dhe disi i lodhshëm, por ndoshta ju tashmë i keni zbatuar shumë nga hapat e përshkruar këtu, edhe pse nuk i njihni ato me një emër formal apo përshkrim të caktuar. Nuk pritet që projekti juaj të prodhojë rezultate të përsosura pasi ju të kaloni në çdo hap të këtij procesi, por qëllimi është që procesi të jetë një cikël që përsëritet - ideja është që me kujdes dhe shpejt të kaloni nëpër secilin hap, të zhvilloni një draft të besueshëm rezultatesh dhe më pas, me kalimin e kohës, të rishikoni punën ndërsa projekti juaj ndryshon dhe maturohet. Po kështu, kur hasni mangësi në të dhëna, mos u bllokoni - deklaroni hipotezat tuaja, përparoni me informacionin më të mirë që keni në dispozicion dhe dokumentoni çdo supozim që po bëni. Planifikimi dhe zbatimi i mirë i një projekti janë një seri e

vazhdueshme e përafrimeve të njëpasnjëshme të ndërtuara mbi supozimet që mund të të testoni në mënyrë sistematike.

Figura 1. Cikli i Menaxhimit të Projektit sipas Standardeve të Hapura PMR, Versioni 3.0



Parimet e Përgjithshme për Zbatimin e Standardeve të Hapura

Ekzistojnë disa parime thelbësore të cilat nuk zbatohen ekskluzivisht në një hap, por në të gjitha hapat e këtyre standardeve. Në vend që t'i listojmë ato për çdo hap, i përshkruajmë këtu.

- **Përfshirja e aktorëve të interesit** – Gjatë zbatimit të projektit tuaj, është e rëndësishme që në çdo hap të përcaktoni dhe të përfshihni aktorët e duhur të brendshëm dhe të jashtëm. Aktorët e interesit janë individë, grupe ose institucione që kanë interes, do të ndikohen ose mund të ndikojnë në aktivitetet dhe rezultatet e projektit. Aktorët e brendshëm dhe të jashtëm ndryshojnë sipas kontekstit të projektit. Megjithatë, zakonisht aktorët e brendshëm janë stafi dhe partnerët që përbëjnë ekipin e projektit, të cilët janë drejtpërsëdrejti përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e tij. Partnerët, për shembull, mund të jenë organizata të tjera, kërkues, anëtarë të komunitetit dhe punonjës zyrtarë. Përveç kësaj, aktorët e brendshëm përfshijnë vendimmarrësit kryesorë të cilët mund të ndikojnë në drejtimin strategjik dhe/ose burimet financiare në dispozicion të projektit. Aktorët e jashtëm të interesit përfshijnë individë dhe institucione të tjera që kanë interes

ose ndikim të mundshëm në projekt, por që nuk janë drejtpërdrejtë përgjegjës për zbatimin e tij (shih Hapin 1D për më shumë detaje mbi analizën e aktorëve të interesit).

- **Zhvillimi dhe forcimi i partneriteteve** – Përgjatë zbatimit të një projekti do t'ju duhet të formalizoni disa nga partneritetet tuaja dhe të punoni për forcimin e tyre gjatë gjithë jetës së projektit. Një ruajtje e suksesshme varet nga krijimi i partneriteteve efektive me aktorët kryesorë të interesit. Shumica e projekteve të ruajtjes ndoshta nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme ose burime të brendshme për të bërë të gjithë punën që duhet bërë. Për më tepër, shumica e projekteve duhet të sigurojnë vazhdueshmërinë/qëndrueshmërinë e punës që është nisur, edhe pas përfundimit të projektit fillestar. Për ta arritur këtë, do të duhet të mobilizohet pjesëmarrja efektive dhe shkëmbimi i informacionit me partnerët gjatë gjithë dhe përtej jetës së projektit. Kjo do të thotë që është e domosdoshme të formohen partneritete në fillim, të rishikohen partneritetet ndërsa kaloni nëpër ciklin e projektit, të formalizohen partneritetet më të përshtatshme duke punuar për të mbajtur marrëdhënie pozitive dhe mbështetëse.
- **Përvetësimi i të nxënit** - Ekipet duhet të jenë të përgatitur për të përvetësuar të nxënin, të njohin dhe pranojnë gabimet, të identifikojnë sukseset dhe të punojnë për të kuptuar pse disa veprime kanë qenë të suksesshme, ndërsa disa të tjerë jo. Është e qartë se një kulturë e të nxënit në mënyrë të organizuar do të ndihmojë në nxitjen e një mjedisi të sigurt mësimi. Krijimi i kësaj kulture kërkon punë dhe angazhim nga nivelet më të ulëta dhe ato më të larta.
- **Dokumentimi i vendimeve tuaja** – Për çdo hap të ciklit të zbatimit të projektit ju mund të shkruani se si vendosët të procedoni më tej, por kjo mund të bëhet shumë e lodhshme. Duhet të vendosni kur është e përshtatshme të dokumentoni vendimet tuaja, në cilin nivel të zbatimit të projektit, por nuk mund të theksojmë mjaftueshëm rëndësinë e dokumentimit të arsyeve për vendimet tuaja në çdo hap. Jo vetëm që kjo ju jep mundësinë të analizoni se pse gjërat kanë ecur ose jo, por shërben gjithashtu si bazë që të tjerët të kuptojnë logjikën e zgjedhjeve tuaja.
- **Përshtatja sipas nevojës** - Hapat e përshkruara në këtë dokument në përgjithësi zbatohen për të gjitha projektet e ruajtjes, por duhet të përshtaten për të përmbushur nevojat e secilit projekt. Në veçanti, secili ekip projekti duhet të detajohet në një nivel të krahasuar me nivelin e kompleksitetit dhe të investimit të projektit të tij. Gjithashtu, disa ekipe projekti mund të arrijnë në përfundimin se disa hapa të ciklit nuk janë të përshtatshëm për ta. Pritet që vetë ekipet duhet t'i përshtasin këto hapa bazë sipas nevojës së tyre.

Supozimet e bëra gjatë zhvillimit të Standardeve të Hapura

Ndërsa ju shqyrtoni dhe zbatoni *Standardet e Hapura*, kini parasysh se një numër supozimesh janë krijuar gjatë kohës së zhvillimit të tyre. Këto përfshijnë:

- **Është paracaktuar kuadri i prioritetëve** - Këto standarde supozojnë që ju dhe/ose organizata juaj ka vlerësuar në një farë niveli prioritetet dhe përcakton se ku, ose për çfarë çështje, ekipi juaj do të punojë. Paracaktimi i prioritetëve është një pararendës i rëndësishëm i zbatimit të këtyre standardeve. Disa nga materialet në *Standardet e Hapura* mund të jenë të dobishme përgjatë përcaktimit të prioritetëve. Përveç kësaj, të nxënit e arritur gjatë zbatimit të këtyre standardeve mund të përdoret përsëri gjatë diskutimeve për vendosjen e prioritetëve në të ardhmen, duke u rikthyer kështu në cikël.

- **Pak projekte do të fillojnë në fillim të këtyre standardeve** - Ndërkohë që është ideale të zbatohen këto standarde që nga fillimi, shumë projekte që do të përfitojnë nga këto standarde tashmë janë në veprim. Ju mund t'i zbatoni këto standarde në projektin tuaj "në mënyrë retroaktive" për t'ju ndihmuar të identifikoni mangësitë që duhet të adresohen për të përmirësuar projektin tuaj. Nëse po mendoni të filloni një projekt të ri, këto standarde mund t'ju ndihmojnë të jeni gjithëpërfshirës në qasjen tuaj.
- **Këto standarde përfaqësojnë "rastin ideal"** - Një lexim i shpejtë i *Standardeve të Hapura* mund të rezultojë i lodhshëm në fillim - me një numër të pafundëm çështjesh që duhet të merren parasysh dhe gjëra për të bërë. Por këto standarde kanë për qëllim të ofrojnë një pamje gjithëpërfshirëse të asaj që përfaqëson idealin në projektimin, menaxhimin dhe monitorimin e projektit. Është e rëndësishme të pranojmë se për një sërë arsyes mund të mos jetë e mundur të adresohet çdo komponent i *Standardeve*. Megjithatë, është e rëndësishme që të përdorni një proces sistematik dhe logjik për zbatimin e *Standardeve*. Për shembull, nuk duhet të identifikoni indikatorët tuaj (Hapi 2B) përpara se të keni menduar për atë që dëshironi të ruani (Hapi 1B). Po kështu, nëse nuk jeni në gjendje të adresoni një komponent të veçantë, duhet të jeni të qartë se si kjo do të ndikojë në pjesën tjetër të punës tuaj.
- **Çdo projekt është i ndryshëm në mënyra potencialisht të rëndësishme** – Në mënyrë të ngjashme me supozimin e mëparshëm, çdo projekt ndryshon në një farë mënyre nga norma. Ne nuk i kemi zhvilluar këto standarde sikundër të ishin "një-masë për të gjithë", por i kemi shkruar ato në kushte mjaft të përgjithshme, në mënyrë që t'i sigurojmë ekipet e projekteve fleksibilitetin që ata kanë nevojë për të përshtatur dhe modifikuar *Standardet* në kushtet e tyre të veçanta. Në fakt, ne besojmë se pikërisht këto dallime - dhe testimi i këtyre standardeve në kontekste të ndryshme – i bëjnë standardet gjithnjë e më të fuqishme dhe të dobishme në kohë.
- **Këto standarde do të ndryshojnë me kalimin e kohës** - Këto standarde nuk janë shkruar për të qenë fjala e fundit mbi mënyrën se si të realizohet ruajtja efektive, por kanë për qëllim për të gjetur mençurinë mbizotëruese në atë që duhet të bëjmë që të kemi ruajtje edhe në kushte të shumëllojshme. Për këtë qëllim, PMR ka qëllim të përditësojë dhe modifikojë rregullisht *Standardet e Hapura* gjatë kohës që ato aplikohen dhe testohen në terren dhe kur rritet njohuria jonë për atë që funksionon dhe nuk funksionon si duhet.
- **Këto standarde zbatohen për projekte të të gjitha masave** - Këto standarde nuk janë hartuar ekskluzivisht për veprime ruajtjeje në një zonë të caktuar. Projektet mund të variojnë nga menaxhimi i zonave të vogla në menaxhimin e rajoneve ekologjike, peisazheve ose korridoreve, ose të përfshijnë menaxhimin e njëkohshëm të zonave të vogla për të arritur ndikim në një shkallë më të gjerë. Përveç kësaj, projektet nuk mund të kufizohen në shkallë gjeografike, por mund të jenë me natyrë më tematike, duke përfshirë, për shembull, reduktimin e kërcënimeve të bazuara në politika, ose iniciativat e fokusuara tek speciet. Për më tepër, këto standarde mund të përdoren për të hartuar programe financimi dhe për të sqaruar marrëdhënien midis objektivave të programit dhe granteve individuale.
- **Këto standarde mund të zbatohen duke përdorur mjete dhe udhëzime të ndryshme** - *Standardet e Hapura* kanë për qëllim të përfaqësojnë gjendjen aktuale të njohurive kolektive të komunitetit të ruajtjes për procesin e hartimit, menaxhimit dhe monitorimit të

projekteve të ruajtjes. Ata ofrojnë udhëzime se si të zhvillohet ruajtja, pavarësisht nga mjeti apo materiali udhëzues (p.sh., MARXAN, Vendim i Strukturuar) që ndihmon në zbatimin e këtyre udhëzimeve.

- ***Këto standarde kërkojnë të përcaktojnë dhe përdorin në mënyrë të qartë terminologjinë***
- Duket se ekziston një debat i pafund midis planifikuesve sa i përket kuptimit relativ të termave teknikë, siç janë qëllimet, objektivat, strategjitë, aktivitetet, gurët e themelit, momentet, produktet dhe rezultatet. Çdo zyrë, projekt, madje edhe individ ka grupin e preferuar të termave. Nuk ka përgjigje të skatë për këtë - megjithatë, *Standardet e Hapura*, pohojnë se është shumë e rëndësishme që anëtarët e ekipit të projektit tuaj dhe njerëzit me të cilët punoni, të kenë një përkufizim të qartë dhe të përbashkët të çfarëdo termi që vendosni të përdorni. Nën këtë logjik, termat teknike në këtë dokument janë përzgjedhur me kujdes, janë nënvizuar kur përkruhen për herë të parë, përdoren vazhdimisht pas kësaj dhe janë përcaktuar në fjalorin e termave në fund. Përzgjedhja e termave specifike për një koncept të caktuar dhe përkufizimet për këto terma bazohen në përdorimin aktual të fjalëve nga profesionistë të disiplinave të ndryshme që punojnë në planifikim, monitorim dhe vlerësim.



Përfshirja e Ndryshimeve Klimatike në *Standardet e Hapura*

Ndryshimet klimatike po ndodhin dhe do të vazhdojnë për të ardhmen e parashikueshme. Temperatura mesatare globale parashikohet të rritet më shumë se 2.0°C në dekadat e ardhshme, shoqëruar me rritjen e nivelit të detit, ndryshimet stinore, stuhi, kohën dhe vëllimin e reshjeve.

Megjithëse në kohën e hartimit të versionit të parë të *Standardeve të Hapura*, në ekranet e radarëve të shumë personave që punojnë në fushën e ruajtjes, ndryshimet klimatike mezi shfaqeshin, trajtimi i tyre në ditët e sotme është një prioritet i ruajtjes globale dhe një çështje që duhet të merret parasysh në hartimin dhe menaxhimin e çdo projekti të ruajtjes. Si të përshtasim dhe të zbatojmë *Standardet e Hapura* për këtë realitet është temë e vazhdueshme e hulumtimeve dhe diskutimeve midis shumë anëtarëve dhe partnerëve të PMR. Është e qartë se *Standardet e Hapura* ofrojnë një kuadër të fuqishëm për rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të përpjekjeve për të reduktuar ndikimet e ndryshimeve klimatike. Sidoqoftë, në kohën e publikimit të versionit 3.0, anëtarët e PMR ende po testonin se si të përshtatin proceset e sugjeruara dhe produktet e *Standardeve*, për të parashikuar dhe përshtatur efektet e pasigurta të ndryshimeve klimatike, dhe se si të përgjigjen më mirë për ndryshimet klimatike. Kjo pasiguri ka të ngjarë të vazhdojë në të ardhmen, por puna e nisur për të përfshirë konsideratat për ndryshimet klimatike në zbatimin e *Standardeve të Hapura* po ndihmon për të sqaruar dhe fokusuar debatet rreth efekteve të ndryshimeve klimatike në biodiversitet dhe çfarë mund dhe duhet të bëhet për të minimizuar ose përmirësuar këto efekte.

Disa mendime aktuale mbi mënyrën e përfshirjes së ndryshimeve klimatike në zbatimin e *Standardeve të Hapura* prezantohen në korniza tektesh përgjatë këtij dokumenti, por PMR vazhdimisht do të bëjë shtesa dhe rishikime. Ndërsa PMR punon për të përshtatur *Standardet e Hapura* për të përfshirë ndryshimet klimatike, ne inkurajojmë ekipet e planifikimit të jenë proaktiv duke kërkuar 1) të kuptojnë dhe të përgjigjen ndaj ndikimeve ekzistuese dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike, krahas kërcënimeve të tjera konvencionale dhe 2) të zhvillojnë dhe zbatojnë veprime që nuk dëmtojnë mundësitë për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike.

Fokusi i këtyre mesazheve në korniza është një thirrje për përshtatje, jo për masa zbutëse. Të dyja janë përgjigje të rëndësishme ndaj ndryshimeve klimatike, por veprimet zbutëse (si strategjitë mbi kërcënimin e drejtpërdrejtë të emetimeve të gazrave serrë) përshtaten mirë brenda kuadrit ekzistues të *Standardeve të Hapura*. Megjithatë përgatitja për përshtatje kërkon zhvillimin e

1. Konceptimi

Ky hap i parë përfshin përcaktimin e parametrave bazë për projektin tuaj si përgatitje për punën e hartimit që do të zhvillohet në hapin tjetër. Në mënyrë të veçantë, konceptimi përfshin përcaktimin e qëllimit të planifikimit, identifikimin se kush do të jetë fillimisht i përfshirë në ekipin e projektit dhe artikullimin e fushëveprimit gjeografik dhe/ose tematik të projektit, vizionin tuaj për atë që shpresoni të arrini dhe objektivat e ruajtjes të cilat do të jenë fokusi i punës suaj. Gjithashtu përfshihet kuptimi i kontekstit të projektit tuaj, duke përfshirë identifikimin e kërcënimeve dhe mundësive, dhe aktorët kryesorë të interesit.

1A. Përcaktoni qëllimin e planifikimit dhe ekipin e projektit

Qëllimi i planifikimit

Planifikimi i projektit ka qëllime të shumta, por ndër më të rëndësishmet është mbështetja e vendimmarrjes gjatë gjithë procesit të planifikimit dhe gjatë zbatimit të mëvonshëm. Ju duhet të jeni shumë të qartë dhe transparent për arsyen pse po planifikoni, duke përfshirë vendimet si dhe vendimmarrësit të cilët plani juaj do të mbështesë. Ju gjithashtu mund të konsideroni të dobishme rishikimin e misionit të organizatës tuaj dhe prioritetet aktuale të saj. Ndër të tjera, kjo do të ndihmojë në sqarimin e vendimeve që tashmë janë marrë, pritshmëritë e vendimmarrësve, koha për marrjen e vendimeve dhe supozimet rreth mundësive të financimit dhe burimeve të tjera. Kjo do t'ju ndihmojë të përcaktoni përpjekjet që duhet të investoni në planifikim dhe cilat hapa janë relativisht më të rëndësishme se të tjerat (për shembull, nëse objektivat dhe qëllimet tashmë janë përzgjedhur dhe një vlerësim kërcënimi tashmë ekziston, atëherë mund të jeni në gjendje t'i rishikoni ato dhe kaloni në analizën e situatës dhe strategjitë). Po ashtu, kur filloni procesin e planifikimit, duhet të mbështeteni në atë që keni mësuar nga projekte të tjera të ngjashme ose versione të mëparshme të të njëjtit projekt. Nëse planifikimi juaj kryhet në bashkëpunim me partnerët, ju duhet të krahasoni fillimisht misionet dhe prioritetet tuaja përkatëse dhe të identifikoni se ku mund të jenë të pajtueshme nevojat dhe vlerat tuaja, si dhe ku ato mund të bien ndesh (këto nganjëherë referohen si interesa parësore, të përshkruara në Seksionin 1D: Analizoni situatën e ruajtjes).

Ekipi i Projektit

Një projekt hartohet dhe zbatohet përfundimisht nga një grup individësh që përbëjnë ekipin e projektit. Anëtarët e ekipit zakonisht janë pjesë e stafit të organizatës suaj, si dhe partnerë të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm. Ekipi zakonisht ka një udhëheqës të projektit, i cili është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe motivimin e ekipit. Duhet të jeni të qartë se kush është në ekipin tuaj dhe cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e çdo anëtari. Përbërja e ekipit mund të ndryshojë ndërsa kaloni nëpër hapat e ciklit të menaxhimit. Megjithatë, njohja dhe përdorimi i aftësive dhe përvojës ekzistuese është çelësi në identifikimin e mangësive për të siguruar që projekti të ecë përpara me njohuritë më të mira në dispozicion. Përveç ekipit të projektit, mund të keni nevojë të identifikoni një ose më shumë këshilltarë, të cilëve ekipi mund ti drejtohet për reagime dhe këshilla të sinqerta, dhe të cilët mund të mbrojnë çështjen tuaj. Pasi të keni bërë analizën e aktorëve të interesit (Hapi 1D), duhet të rishikoni ekipin e projektit dhe të përcaktoni nëse ndonjë nga aktorët e interesit të identifikuar në hapin 1D duhet të jetë pjesë e ekipit e tij. Kjo kërkon që ekipi juaj të jetë fleksibël dhe i hapur për të mirëpritur anëtarë të rinj, nëse është e përligjur. Në përgjithësi, kjo lëvizje para dhe pas nëpër hapat e ciklit është pjesë e natyrës përsëritëse të menaxhimit adaptiv.

Produktet e këtij hapi përfshijnë:

- ◆ *Identifikimin i qëllimit të planifikimit dhe vendimeve të cilat plani do t'i mbështesë.*
- ◆ *Identifikimi i vendimeve tashmë të marra dhe i çdo kufizimevi apo limiti.*
- ◆ *Përzgjedhja e ekipit fillestar të projektit, duke përfshirë udhëheqësin e projektit, anëtarët kryesorë dhe anëtarët këshillimorë.*
- ◆ *Identifikimi i aftësive kryesore që secili anëtar i ekipit sjell.*
- ◆ *Identifikimi i mangësive në aftësitë ose njohuritë që ekipi juaj duhet të plotësojë.*
- ◆ *Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi.*

1B. Përcaktoni fushëveprimin, vizionin dhe targetet e ruajtjes

Fushëveprimi

Përpara se të filloni të mendoni për atë që do të bëni (strategjitë që do të zbatoni), duhet të keni të qartë atë që shpresoni të përmbushni në linja të përgjithshme. Fushëveprimi i projektit përcakton se çfarë synon të ndikojë projekti. Projektet e “bazuar në vendndodhje” kanë një shtrirje gjeografike dhe përfshijnë përpjekjet për të ruajtur ose menaxhuar në mënyrë efektive rajonet ekologjike, zonat prioritare ose zonat e mbrojtura. Projektet e “bazuar në tematika” përfshijnë përpjekjet për të adresuar objektivat specifike të ruajtjes, kërcënimet, mundësitë, ose kushtet e mundshme dhe në përgjithësi kanë një shtrirje tematike respektive. Projektet tematike mund të përcaktojnë gjithashtu një fushëveprim gjeografik që përshkruan hapësirën e zonës së projektit dhe mund të referojnë elemente specifike të biodiversitetit ose një kërcënim specifik.

Në çdo projekt me fushëveprim gjeografik, shpesh është e dobishme të zhvillohet një hartë hapësinore e zonës suaj të projektit.

Vizioni

Përveç përcaktimit të qëllimit, është gjithashtu e nevojshme të vendosni për një vizion të qartë dhe të përbashkët i cili përfaqëson një përshkrim të gjendjes së dëshiruar ose gjendjes përfundimtare për të cilën po punoni që ta arrini. Vizioni juaj mund të përmbledhet në një formulim vizioni, i cili plotëson kriteret për të qenë *relativisht i përgjithshëm, vizionar dhe i shkurtër* (shih Shtojcën 2 për përshkrimet e këtyre kriterëve). Vizioni i një projekti duhet të përshatet brenda kontekstit të misionit të përgjithshëm të organizatës suaj.

Targetet e ruajtjes

Në një projekt zgjidhet një numër i kufizuar targetesh për ruajtjen (të njohur edhe si targetet e biodiversitetit)⁵. Targetet e ruajtjes janë specie specifike ose sisteme/habitat ekologjike të cilat janë zgjedhur për të përfaqësuar dhe për të përfshirë të gjithë biodiversitetin e zonës së projektit për të arritur ruajtjen me shtrirje tematike apo gjeografike. Ato janë baza për përcaktimin e qëllimeve, kryerjen e veprimeve të ruajtjes dhe matjen e efektivitetit të ruajtjes. Për ruajtjen e bazuar në vendndodhje, një paketë e plotë e targeteve të ruajtjes teorikisht do të sigurojë ruajtjen e të gjithë biodiversitetit vendas brenda zonës së projektit. Për shkak se projektet me bazë tematike kanë një fokus më të ngushtë, në një specie, kërcënim ose temë tjetër, ekipet që zbatojnë këto projekte, sipas përkufizimit, nuk do të punojnë për të ruajtur të gjithë



Konsiderata për Ndryshimin e Klimës 1.Fushëveprimi

Në përcaktimin e qëllimit tuaj, ju mund të dëshironi të merrni në konsideratë se si ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në fushëveprimin tuaj. Kjo mund të përfshijë marrjen parasysh nëse ekosistemet ose llojet kanë gjasa të ndryshojnë ose shpërndarja e specieve brenda një ekosistemi ka të ngjarë të ndryshojë. Gjithashtu, mund të konsideroni lëvizjet e mundshme latitudinale, sipas lartësisë ose lëvizje të tjera që ndikojnë në speciet kryesore dhe/ose komunitetet bimore dhe si këto mund të ndikojnë në fushëveprimin tuaj. Shtrirja juaj duhet të bazohet në njohuritë më të mira shkencore në dispozicion. Megjithatë, mbani në mend se ndikimet e ndryshimeve klimatike nuk njihen mirë. Monitorimi do të jetë kyç për testimin e hipotezave dhe përcaktimin nëse qëllimi juaj duhet të ndryshojë ose jo me kalimin e kohës.

⁵ Disa njerëz e lidhin termin "target" me vlerën numerike në një qëllim dhe preferojnë të përdorin një term tjetër si një sinonim. Disa sinonime të përgjithshme janë termat komponent, funksion dhe vlerë.

biodiversitetin vendas. Shumica e projekteve të bazuara në vendndodhje mund të përcaktohen në mënyrë të arsyeshme nga tetë ose më pak targete të ruajtjes të zgjedhur mirë. Megjithatë, projektet me shtrirje më të gjerë gjeografike, mund të kërkojnë disa targete më shumë ose targete "më të ashpër" (p.sh. në vend të një lloji të veçantë shpendi, një grup llojesh). Projektet tematike shpesh karakterizohen duke u fokusuar në një target kryesor ruajtjeje - ose në një kërcënim kryesor që prek targetet e shumtë të ruajtjes (p.sh., një projekt për të ruajtur balenat blu ose një projekt për të reduktuar tregtinë botërore të llojeve të rrezikuara).

Aty ku është e përshtatshme, mund të jetë e dobishme të përcaktohet në hartë hapsira e shtrirjes së targetit të ruajtjes. Përzgjedhja e targeteve të ruajtjes zakonisht kërkon të dhëna nga ekspertët dhe analizën e të dhënave hapësinore në rezoluta të ndryshme. Nëse targeti juaj i ruajtjes haset në masë të gjerë (p.sh., një lloj shpendi në të gjithë zonën e shtrirjes së tij ose shtrirja e plotë një tip ekosistemi), mund të jetë e dobishme që ai të ndahet në nën-targete specifike hapësinore (p.sh. popullatat specifike të llojeve të shpendëve).

Në disa raste, sidomos kur punoni në grupe, misioni kryesor i të cilit nuk është ruajtja e biodiversitetit, mund të dëshironi të tregoni se si puna në fushën e ruajtjes në fund të fundit ndikon njerëzit. Në këto raste, ekipet mund të shtojnë targetet e mirëqenies njerëzore. Siç përcaktohet nga Vlerësimi i Ekosistemit të Mijëvjeçarit, mirëqenia njerëzore përfshin: 1) materialin e nevojshëm për një jetë të mirë, 2) shëndetin, 3) marrëdhënie të mira shoqërore, 4) sigurinë dhe 5) lirinë dhe zgjedhjen. Në kontekstin e një projekti të ruajtjes, targetet e mirëqenies njerëzore fokusohen në ato komponente të mirëqenies njerëzore të prekura nga statusi i targeteve të ruajtjes. Objektivat e mirëqenies njerëzore mund të shtohen si pjesë e Hapit 1D, Analiza e gjendjes së ruajtjes.




Konsiderata për Ndryshimin e Klimës 2. Targetet e Ruajtjes

Kur identifikoni targetet e ruajtjes, mund të konsideroni nëse ekosistemet, habitatet dhe speciet do të vazhdojnë të mbeten në zonën gjeografike në një të ardhme të parashikueshme, duke marrë parasysh ndryshimet e parashikuara klimatike. Ju gjithashtu mund të dëshironi të konsideroni se si ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e targetit dhe nëse, në dritën e ndryshimeve të parashikuara, veprimtaritë në kuadër të projektit tuaj mund të jenë ende efektive në ruajtjen ose përmirësimin e shëndetit të targetit tuaj të ruajtjes.

Më pas ju duhet të përcaktoni statusin aktual të çdo targeti të ruajtjes. Në nivelin më bazik, ky proces përfshin vlerësimin e përgjithshëm të "shëndetit" të secilit target të ruajtjes. Vlerësimet më të detajuara të statusit të ruajtjes përfshijnë përcaktimin e atributeve kryesore ekologjike të secilit target të ruajtjes, përcaktimin e indikatorëve për secilin atribut, duke nënvizuar mendimin tuaj se cili është kufiri më i pranueshëm i variacionit për secilin indikator dhe përfundimisht përcaktimin e statusit aktual të atributit në lidhje me këto kufij variacioni. Nëse e keni ndarë targetin tuaj në nën-targete, mund t'ju duhet të vlerësoni statusin e secilit nën-target. Ky informacion përcakton themelin për të përcaktuar një qëllim të mirë për targetin tuaj të ruajtjes (shih Hapin 2A).

Figura 2. Model i përgjithshëm i një projekti të pjesshëm i cili tregon shtrirjen, vizionin dhe targetet e ruajtjes



Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ◆ ***Përshkrim i shkurtër i fushëveprimit të projektit.***
- ◆ ***Nëse është e përshtatshme, një hartë të zonës së projektit (skedar GIS ose skicë me dorë).***
- ◆ ***Formulimi i vizionit të projektit.***
- ◆ ***Përzgjedhja e targeteve të ruajtjes, duke përfshirë një shpjegim të shkurtër për arsyet pse janë zgjedhur dhe nëse është e përshtatshme, një përshkrim dhe/ose hartë që tregon vendndodhjen e secilit target.***
- ◆ ***Përshkrimi i statusit të secilit target prioritar të ruajtjes.***

1C. Identifikoni Kërcënimet Kritike

Pasi të keni vendosur cilët do të jenë targetet tuaj prioritarë të ruajtjes, duhet të identifikoni kërcënimet e drejtpërdrejta⁶ që ndikojnë në këto targete. Kërcënimet e drejtpërdrejta janë kryesisht *aktivitete njerëzore* që menjëherë e degradojnë një target ruajtjeje (p.sh. peshkimi i paqëndrueshëm, gjuetia e paqëndrueshme, shpimet e naftës, ndërtimi i rrugëve, ujërat e zeza

⁶ Disa ekipe mund të mos e pranojnë termin "kërcënim", veçanërisht kur punojnë me aktorët e interesit, veprimet ose profesionet e të cilëve mund të identifikohen si "kërcënim". Disa sinonime të përgjithshme që mund të jenë më pak të kundërshtuara përfshijnë presionin dhe burimin e stresit.

industriale ose futja e llojeve ekzotike invazive), por mund të jenë edhe fenomene natyrore të ndryshuara nga aktivitetet njerëzore (p.sh. rritja e stuhive ekstreme ose rritja e avullimit për shkak të ndryshimeve klimatike globale), ose në raste të rralla, një fenomen natyror, ndikimi i të cilit rritet nga aktivitete të tjera njerëzore (p.sh. një cunami potencial që kërcënon popullatën e fundit të mbetur të një rhinoceronti aziatik). Aty ku është e përshtatshme, mund të jetë e dobishme të përcaktoni gjurmën hapësinore të një kërcënimi.

Si pjesë e analizës suaj të kontekstit të projektit, është gjithashtu e rëndësishme të prioritetizoni kërcënimet e drejtpërdrejta që ndikojnë në targetet tuaja të ruajtjes, në mënyrë që të përqendroni aktivitetet tuaja atje ku ato janë më të nevojshme. Në veçanti, duhet të përpiqeni të përcaktoni kërcënimet kritike - ato që janë më të rëndësishme për tu adresuar. Është e rëndësishme të konsideroni të gjithë paketën e kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe të mos e kufizoni analizën tuaj vetëm në kërcënimet ku ekipi ose organizata juaj ka ekspertizë ose burime për t'i adresuar.

Ka disa mjete për të vlerësuar dhe renditur kërcënimet, të cilat mund të përdoren për të ndihmuar procesin e prioritarizimit. Shumica e këtyre mjeteve vlerësojnë fushëveprimin ose shtrirjen e kërcënimit dhe ashpërsinë e tij në targetet e ruajtjes. Të marra së bashku, këto dy kritere vlerësojnë madhësinë e përgjithshme të kërcënimit. Kritere të tjera të përdorura zakonisht përfshijnë qëndrueshmërinë/pakthyeshmërinë dhe ngulmimin. Në varësi të rrethanave, ju mund t'i vlerësoni kërcënimet sipas ndikimit që ato kanë në një zonë të përgjithshme ose t'i vlerësoni ata sipas ndikimit që kanë në targetet specifike të ruajtjes, duke përfshirë edhe ato që mund të përcaktojnë një program tematik.

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:



Konsiderata për Ndryshimet Klimatike 3. Vlerësimi i Kërcënimeve dhe Cenueshmërisë

Ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në shfaqjen e një kërcënimi të ri për një target dhe/ose të bashkëveprojnë me kërcënimet të tjera për të përkeqësuar një kërcënim ekzistues ose për të vendosur nën stres një target ruajtjeje.

Një mjet i zakonshëm për të vlerësuar efektet ekzistuese dhe të mundshme të ndryshimeve klimatike në një target ruajtje është vlerësimi i cenueshmërisë. Mund të jetë e nevojshme të kryeni një vlerësim cenueshmërie për ndryshimet klimatike për të ndihmuar ekipin tuaj të projektit të identifikojë ekspozimet specifike ndaj ndryshimeve klimatike (p.sh. rritjet e temperaturës, ndryshimet e reshjeve, ngjarjet ekstreme si stuhitë dhe thatësitrat, acidifikimi i oqeanit dhe rritja e nivelit të detit) ndaj të cilave objektivat e ruajtjes janë më të ndjeshme. Ju gjithashtu mund të identifikoni kapacitetin përshtatës të targeteve tuaj në përgjigje të këtyre ekspozimeve. Mund të jetë e dobishme për të përfshirë ekspozimet klimatike në modelin tuaj konceptual (Hapi 1D).

Për të përfshirë plotësisht ndryshimet klimatike, mund të jetë e dobishme të përfshihen pasojat ekologjike të ekspozimeve klimatike si stresa në modelin tuaj konceptual dhe të bëni një vlerësim të kërcënimit të bazuar në stres. Në këtë mënyrë ju mund të kuptoni më mirë nëse ndryshimet klimatike po çojnë në një stres të ri dhe/ose se si ekspozimi ndaj klimës mund të jetë duke

- ♦ **Identifikimi i kërcënimeve të drejtpërdrejta dhe nëse është e përshtatshme, një hartë që tregon gjurmën hapësinore për çdo kërcënim.**
- ♦ **Vlerësimi ose renditja e kërcënimeve të drejtpërdrejta për të identifikuar kërcënimet kritike.**

1D. Analizoni rrethanat e ruajtjes

Ky standard ju kërkon të përshkruani rrethanat ose "situatën" brenda së cilës zhvillohet projekti juaj. Analiza e situatës është një proces që do t'ju ndihmojë që ju dhe ekipi i projektit tuaj të krijojnë një kuptim të përbashkët të kontekstit të projektit - duke përfshirë përshkrimin e marrëdhënieve ndërmjet mjedisit biologjik dhe sistemeve sociale, ekonomike, politike, institucionale dhe mekanizmave që ndikojnë në targetet e ruajtjes që ju doni të arrini. Në varësi të shkallës së projektit dhe burimeve në dispozicion të tij, analiza e situatës mund të jetë një studim i thelluar formal i zonës/problemit ose një përshkrim më pak formal bazuar në informacionin e atyre që njohin zonën/problemin. Ky është një hap që ndonjëherë neglizhohet në projektet e ruajtjes, të paktën në mënyrë eksplicite, por është një nga më të rëndësishmet. Duke kuptuar kontekstin, do të jeni më të përgatitur për përzgjedhjen e strategjive dhe identifikimin e aktiviteteve për të arritur qëllimet dhe objektivat tuaja të ruajtjes.

Ky standard ndërtohet si rezultat i punës që keni bërë tashmë me kontekstin e projektit (fushëveprimi, targetet e ruajtjes dhe kërcënimet direkte). Ai përfshin përfundimin e analizës së situatës duke identifikuar faktorët kryesorë që ndikojnë në kërcënimet e drejtpërdrejta dhe në fund ndikojnë në targetet tuaja të ruajtjes. Këto përfshijnë kërcënimet e tërthorta (të njohura edhe si shkaqet bazë dhe forcat shtytëse), mundësitë dhe kushtet mundësuese. Këta faktorë mund të veprojnë si në shkallë lokale ashtu edhe globale.

Secili faktor mund të lidhet zakonisht me një ose më shumë aktorë interesi – ata individë, grupe apo institucione që kanë një interes të dhënë ose mund të ndikojnë në burimet natyrore të zonës së projektit dhe/ose që potencialisht do të preken nga aktivitetet e projektit dhe kanë diçka për të fituar ose humbur nëse kushtet ndryshojnë ose qëndrojnë të njëjta. Si pjesë e analizës suaj të situatës, duhet të kryeni një analizë të aktorëve të interesit. Analiza e aktorëve të interesit ndihmon që të qartësohen situata/marrëdhënie që mund të kërkojnë vëmendje dhe që ndikojnë në suksesin apo dështimin e projektit. Ju duhet t'i konsideroni të dy palët, aktorët e fuqishëm dhe me influencë, si dhe ata që mund të jenë të pafavorshëm ose të marginalizuar. Gjatë shqyrtimit të aktorëve të interesit, kini gjithashtu parasysh se cilët aktorë interesi ka gjasa të jenë partnerë të rëndësishëm strategjikë për projektin tuaj (shih Hapin 1A). Mbani gjithmonë në vëmendje se edhe ju dhe ekipi juaj jeni aktorë interesi.

Një produkt i rëndësishëm i analizës së aktorëve të interesit është identifikimi i interesave parësore – ajo çfarë realisht i'u intereson apo vlerësojnë aktorët tuaj të interesit. Përcaktimi i interesave parësore ndihmon në bërjen transparente të arsyes së sjelljeve apo vendimeve të caktuara që marrin aktorët kryesorë të interesit. Për shembull, një organizatë që punon në fushën e ruajtjes mund të kujdeset përfundimisht për ruajtjen e pyjeve tropikale për një periudhë afatgjatë (në kuadër të *Standardeve të Hapura*, ky interes parësor konsiderohet si gjendja e dëshiruar për një target të ruajtjes); një individ mund të interesohet më shumë për sigurinë e ushqimit për familjen e tij; dhe një komunitet mund të interesohet më shumë për të pasur qasje afatgjatë për furnizimin me ujë të pastër. Si një ekip që punon në fushën e ruajtjes, ju nuk mund

t'i adresoni të gjitha interesat parësore të aktorëve tuaj të interesit. Megjithatë, është e rëndësishme që ju ti njihni ato dhe mënyrën se si mund të ndikojnë në projektin tuaj.

Disa interesa mund të shndërohen në targete ose përfitime të mirëqenies njerëzore, ose mund t'ju drejtojnë që të ripërcaktoni targetet e ruajtjes. Disa interesa të tjera mund të përfundojnë si kufizime ose mundësi të cilat mund të përdoren për të bërë më vonë zgjedhje më të zgjuara midis strategjive të mundshme. Përcaktimi i interesave gjithashtu do të ndihmojë në identifikimin e pengesave të mundshme dhe do të kufizojë mundësinë që ju në mënyrë të pa vetëdijëshme të mund të dëmtoni interesat e aktorëve të interesit ose të krijoni konflikte të panevojshme. Për shembull, analiza e aktorëve të interesit identifikon fermerët si një palë e interesuar, për të cilët interes parësor është ruajtja e mënyrës së jetesës për familjet e tyre, e cila përfshin mbrojtjen dhe sigurimin e bagëtisë. Për shkak të interesave të tyre, fermerët mund të mbajnë qëndrim negativ rreth ujqërve, pavarësisht se statistikisht tregojnë një rënie të ulët të këtyre grabitqarëve. Një ekip që punon për të ruajtur popullatat e ujqërve do ta konsideronte këtë qëndrim si një kufizim ose kërcënim të tërthortë për interesat e tij, në mënyrë që më vonë të mendojë se çfarë rëndësie ka ky qëndrim dhe nëse ekipit i duhet të hartojë ose jo një strategji për ta adresuar atë (shih Hapin 2A).

Një mënyrë për të gjetur/kuptuar/identifikuar marrëdhëniet ndërmjet targeteve të ruajtjes, kërcënimeve, mundësive dhe interesave parësore është të ndërtohet një model konceptual. Modeli konceptual është një mjet që vizualisht portretizon marrëdhëniet midis faktorëve të ndryshëm në analizën e situatës (shihni figurën 3 për një model të përgjithshëm dhe figurën 4 për një shembull nga bota reale e një projekti “me bazë vendndodhjeje. Për një shembull projekti me “bazë tematike” shih Shtojcën 4). Një model i mirë ilustron marrëdhëniet kryesore shkak - pasojë që ju dhe ekipi juaj supozoni se ekzistojnë brenda zonës ose tematikës së projektit. Ai duhet të jetë sa më i thjeshtë të jetë e mundur, por gjithmonë duke përfshirë detajet më të rëndësishme. Për këtë qëllim, një model konceptual për një projekt në shkallë të gjerë do të duhet të ketë një kornizë "më të ashpër" sesa një model për një projekt në shkallë më të vogël. Për të siguruar që modeli juaj konceptual përfaqëson në vija të përgjithshme mendimin e ekipit tuaj për kontekstin në të cilin po punoni, duhet ta ndërtoni atë si një ekip. Po ashtu, është ideale të testohet modeli në terren me aktorët dhe partnerët kyç brenda dhe jashtë ekipit të projektit, për të siguruar që modeli reflekton kuptimin e tyre të situatës. Ndërsa zhvillonin dhe testonin modelin tuaj konceptual, duhet të mbani shënim se çfarë dini dhe për çfarë mund të jenë të nevojshme kërkime apo analiza të mëtejshme.

Figura 3. Një model konceptual i përgjithshëm i cili tregon konceptin e projektit






Figura 4. Shembull i një modeli konceptual për zonat e pellgjeve ujëmbledhës



Nëse ekipi i një projekti vendos që është e rëndësishme të sqarohen për publikun përfitimet përfundimtare të punës së tyre të ruajtjes, atëherë në punën e tyre duhet të përfshihen targetet e mirëqenies njerëzore⁷. Në kontekstin e një projekti të ruajtjes, targetet e mirëqenies njerëzore fokusohen në ato komponente të mirëqenies njerëzore të prekur nga statusi i targeteve të ruajtjes. Për shembull, mjetet e jetesës të bazuara në pylltari mund të jenë një target i mirëqenies njerëzore në një projekt që po punon për të ruajtur burimet pyjore për biodiversitetin dhe qëllimet e qëndrueshme të përdorimit të njeriut. Të gjitha targetet e mirëqenies njerëzore në një zonë të caktuar duhet të përfaqësojnë kolektivisht tablonë e nevojave të mirëqenies njerëzore të varur nga objektivat e ruajtjes.

Figura 5. Marrëdhënia e përgjithshme midis targeteve të ruajtjes dhe targeteve të mirëqenies njerëzore



Në një model konceptual, targetet e mirëqenies njerëzore vendosen në të djathtë të targeteve të ruajtjes, të influencuar nga statusi i targeteve të ruajtjes dhe shërbimet e ekosistemit të cilat varen nga ruajtja e biodiversitetit (Figura 5 dhe Figura 6). Edhe pse mund të jenë të rëndësishëm në mënyrë kritike, ato nuk përfaqësojnë frocën shtytëse të një projekti të ruajtjes. Si të tillë analizohen gjatë analizës së situatës dhe jo përgjatë Hapit 1B. Sikundër përshkruhet më tej në Hapin 2A mbi supozimet dhe objektivat, disa strategji ruajtje mund të kenë rezultate të një natyre me përfitim social, të cilat përgjatë procesit të planifikimit trajtohen ndryshe nga targetet e mirëqenies njerëzore. Figura 7 paraqet një shembull tjetër për një projekt me “bazë tematike”.

⁷ Siç përcaktohet nga Vlerësimi i Ekosistemit të Mijëvjeçarit, mirëqenia njerëzore përfshin: 1) materialin e nevojshëm për një jetë të mirë, 2) shëndetin, 3) marrëdhëniet e mira shoqërore, 4) sigurinë dhe 5) lirinë dhe zgjedhjen.

Figura 6. Shembull i një modeli konceptual, pjesa e cila ka të përfshirë targetet e mirëqenies njerëzore





Figura 7. Shembull i targeteve të mirëqenies njerëzore për një projekt tematik



Çelësi	
 Kërcënim i drejtpërdrejtë	 Target i ruajtjes
 Faktor kontribues ose shërbim ekosistemi	 Target i mirëqenies njerëzore

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ◆ **Identifikimi dhe analiza e kërcënimeve të tërthorta dhe mundësive.**
- ◆ **Nëse është e rëndësishme, përzgjedhja e targeteve të mirëqenies njerëzore, duke përfshirë një shpjegim të shkurtër për arsyen se pse janë zgjedhur.**
- ◆ **Vlerësimi i aktorëve të interesit dhe interesat e tyre parësore.**
- ◆ **Modeli konceptual fillestar që ilustron marrëdhëniet kryesore shkak - pasojë midis faktorëve që veprojnë në zonën e projektit tuaj.**
- ◆ **Testimi në terren dhe rishikimi i modelit.**

2. Planifikoni aktivitetet tuaja dhe Monitorimin

Pasi të keni përshkruar parametrat bazë për projektin tuaj, hapi tjetër është të përcaktoni qëllimet dhe strategjitë. Në mënyrë të veçantë, ky hap përfshin përcaktimin dhe zhvillimin e qëllimeve, strategjive dhe objektivave të projektit, si dhe identifikimin e supozimeve që do të bëni për mënyrën se si strategjitë tuaja do të arrijnë me të vërtetë qëllimet e projektit. Të gjitha këto, qëllimet, strategjitë, objektivat dhe supozimet themelore të projektit përfshijnë Planin e Veprimit të projektit tuaj.

2A. Hartoni një Plan Formal Veprimi: Qëllimet, Strategjitë, Supozimet dhe Objektivat

Qëllimet

Zhvillimi i një ideje të qartë të asaj që dëshironi të përmbushni është pjesa e parë thelbësore e hartimit të Planit të Veprimit tuaj. Qëllimet janë të lidhura me targetet e ruajtjes së projektit dhe përfaqësojnë statusin e dëshiruar të targeteve të ruajtjes në terma afatgjatë - ato janë deklaramë formale të ndikimit përfundimtar që shpresoni të arrini. Një qëllim i mirë plotëson këto kritere: *lidhet me objektivat, i orientuar kundrejt ndikimit, i matshëm, i arritshëm në kohë dhe specifik (shih Aneksin 2).*

Nëse keni bërë një vlerësim të qëndrueshmërisë në Hapin 1B, ju tashmë i keni përcaktuar elementet e një qëllimi të mirë sepse e dini se çfarë ju nevojitet për të patur targete të shëndetshëm të ruajtjes (atributet kryesore ekologjike), ju e dini se kur shpresoni të arrini statusin e dëshiruar, dhe ju e dini se çfarë keni nevojë të masni për të vlerësuar shëndetin e tij. Zhvillimi i një qëllimi është vetëm një çështje që të shndërroni këtë informacion në një deklaratë qëllimi. Duke u kthyer në shembullin e vendndodhjes së pellgut ujëmbledhës të lumit të Bardhë (Figura 4), një qëllim për korridorin pyjor si target i ruajtjes mund të jetë: Deri në vitin 2030, gjerësia e korridorit pyjor që lidh pellgun ujëmbledhës të lumit të Bardhë me lumenjtë në Los Grillos është të paktën 5 km i gjerë dhe mbetet i pa fragmentuar.



Konsiderata për Ndryshimet Klimatike 4. Përcaktimi i qëllimit

Kur vlerësoni qëndrueshmërinë dhe përcaktimin e qëllimeve, ju duhet të siguroheni që qëllimet tuaja janë ende të arritshme duke pasur parasysh efektet e ekspozimeve ndaj ndryshimeve klimatike të cilat i keni identifikuar në analizën tuaj të situatës.

Nëse në një projekt janë përcaktuar edhe targetet e mirëqenies njerëzore dhe, si rrjedhojë, pretendohet të arrihen produkte që ndikojnë mirëqenien njerëzore, duhet që të përcaktohen qëllime edhe për këto targete. Ekipi mund të dëshirojë gjithashtu të përcaktojë atributet kryesore për targetet e tij të mirëqenies njerëzore, por anëtarët e ekipit duhet të sigurohen që këtotribute të jenë të qarta në varësi të statusit të targetit të ruajtjes dhe /ose shërbimeve të ekosistemit që ato ofrojnë. Për shembull, një ekip që punon në fushën e ruajtjes ndoshta nuk do të përcaktojë qëllime të mirëqenies njerëzore lidhur me reduktimin e infeksionit të HIV-it ose uljen e niveleve të kolesterolit, edhe pse këto mund të jenë të rëndësishme për shëndetin e njeriut. Megjithatë, ekipi mund të ketë qëllime të mirëqenies njerëzore në lidhje me qasjen në burimet ushqimore, sepse targetet biologjike të ruajtjes po përmirësojnë shërbimet e pjalmimit të bimëve.

Strategjitë

Sapo të përcaktoni se çfarë doni të arrini (qëllimet tuaja), duhet më pas të mendoni rreth asaj që duhet të bëni për ta arritur (strategjitë dhe aktivitetet). Një planifikim i mirë strategjik përfshin përcaktimin se ku dhe si do të ndërhyni - dhe gjithashtu aty ku nuk do të ndërhyni.

Pikat kryesore të ndërhyrjes: Zgjedhja e faktorëve që do të ndikoni

Vendimi i parë që duhet të merrni është që të priorizoni në modelin tuaj konceptual faktorin për të cilin duhet të ndërmerreni një veprim - këto janë pikat kryesore të ndërhyrjes.

Në teori, çdo faktor në një model konceptual ofron një mundësi për ndërhyrje; e cila mund të jetë ripozicionim i drejtpërdrejtë i një targeti, heqje e drejtpërdrejtë ose zvogëlim i një kërcënimi, ose veprime për të ndikuar në një kërcënim të tërthortë ose mundësi. Në disa raste, pika më e qartë e ndërhyrjes kyçe është vetë kërcënim i drejtpërdrejtë (p.sh., një projekt për të hequr një specie invazive). Por në shumë raste të tjera, ju merrni më shumë lëvizshmëri nëse ndërhyrja në një kërcënim të tërthortë ose mundësi i/e cila është pjesë e një zinxhiri faktorësh që ndikojnë në një kërcënim të drejtpërdrejtë. Për shembull, në Figurën 8, pikat kryesore të ndërhyrjes janë të theksuara dhe përfshijnë: kërkesën për havjar; korrje të blijës, rregullime të papërshtatshme të zonimit, urbanizim i shpejtë, kërkesa për shtëpi të dyta, pastrimin e ndërtimeve të reja në shtëpi dhe korridoret pyjore (një target ruajtjeje).

Për të identifikuar pikat kryesore të ndërhyrjes për veprim, ju duhet të vlerësoni të gjithë faktorët në modelin tuaj konceptual dhe të identifikoni ata që mund të shfrytëzohen më së miri për arritjen e qëllimeve të projektit. Disa konsiderata për të vlerësuar potencialin e levave për të ndikuar tek faktorë të caktuar përfshijnë: kontributi në zvogëlimin e kërcënimeve, aftësia për të ndikuar në faktorë të shumtë në model dhe urgjenca e adresimit të faktorit (ose faktorëve të saj në drejtim të poshtëm). Proceset e përcaktimit dhe prioritizimit të pikave kryesore të ndërhyrjes, strategjive gjeneruese dhe strategjive të përzgjedhjes janë shumë të ndërlidhura dhe një qasje përsëritëse do të jetë më e vlefshme për vendimarrjen.

Strategjitë: Të vendosni se si do të ndërhyrni

Pasi të keni prioritizuar pikat kryesore të ndërhyrjes, ju duhet të gjeneroni një listë të strategjive të mundshme që adresojnë këto pika ndërhyrjeje dhe pastaj zgjidhni ato me potencialin më të



Konsiderata për Ndryshimet Klimatike 5. Identifikimi i pikave të ndërhyrjes të cilat lidhen me ndryshimet klimatike

Kur identifikoni pikat e ndërhyrjes për strategjitë e adaptimit që lidhen me ndryshimet klimatike, mund të përdorni elementë të të menduarit tuaj nga hapat e mëparshëm për të zhvilluar strategji të cilat:


- Reduktojnë stresin e lidhur me ndryshimet klimatike në targetin tonë duke punuar me kërcënime të tjera jo me natyrë klimatike por që kontribuojnë gjithashtu në atë target stresi (p.sh., zvogëlimi i pastrimit bujqësor të pemëve bregore në mënyrë që rrymat të mbesin të hijëzuara dhe të mbrojtura nga rritja e temperaturës);
- Restaurojnë për të zvogëluar stresin e lidhur me klimën në targetin tonë (p.sh. restaurimin e habitatit duke shtuar më shumë lloje tolerante ndaj thatësirës)
- Zvogëlojnë një kërcënim jo klimatik me qëllim rritjen e kapacitetit adaptiv të targetit të ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike (p.sh. zvogëlimin e kërcënimit të zhvillimit duke mbrojtur zonat që sigurojnë lidhjen e habitateve në mënyrë që speciet të përshtaten më mirë duke u zhvendosur në zona më të përshtatshme gjatë kohës që ndodhin ndryshimet klimatike); dhe/ose
- Mbrojnë dhe/ose restaurojnë zhvillimin e atij targeti që mund të jetë më pak i ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike (Strehimi kimatik - p.sh., mbrojnë veçanërisht rrjedhat e ujit të ftohtë që ka gjasa të vazhdojnë të sigurojnë habitatin për speciet e ndjeshme ndaj temperaturës, ndërkohë që zonat e tjera bëhen më të ngrohta).

Të gjitha këto janë strategjitë e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike. Natyrisht, një projekt mund të punojë drejtpërdrejt në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Sidoqoftë, për projektet më të vogla, veprimi në këtë mënyrë mund të jetë përtej fushës së asaj që ata mund të ndikojnë në mënyrë të

madh për të arritur qëllimet e projektit tuaj. Një strategji është një grup veprimesh me një fokus të përbashkët që punojnë së bashku për të arritur qëllimet dhe objektivat specifike duke synuar pikat kryesore të ndërhyrjes, duke integruar mundësitë dhe duke zvogëluar kufizimet. Këto mund të përfshijnë një gamë të gjerë veprimesh për ruajtjen siç janë restaurimi i habitateve, mbrojtja e tokës, ndryshimi i politikave ose arsimit. Procesi i krijimit dhe përzgjedhjes së strategjive është përgjithësisht një proces me tre pjesë i cili përfshin hulumtimin e strategjive ekzistuese, krijimin e strategjive të reja dhe zgjedhjen e strategjive optimale.

Figura 8. Shembull i një modeli konceptual për vendndodhjen e pellgut ujëmbledhës me pikat kryesore të ndërhyrjes dhe strategjitë

Pikat kryesore të ndërhyrjes tregohen me të medha të theksuara



Hulumtimi i strategjive ekzistuese përfshin hetimin se si të tjerët janë përpjekur të ndërhyjnë në situata të ngjashme dhe nëse këto ndërhyrje kanë qenë të suksesshme apo kanë dështuar dhe pse. Gjenerimi i strategjive të reja integron atë që një ekip ka mësuar gjatë analizës së situatës dhe hulumtimit të strategjisë me procese krijuese për të zhvilluar një sërë zgjidhjesh të mundshme. Qëllimi këtu është identifikimi i strategjive të ndryshme që mund të arrijnë qëllimet e ruajtjes së projektit, duke marrë parasysh gjithashtu mundësitë dhe kufizimet që i bëjnë disa strategji të veçanta më të realizueshme ose më pak të realizueshme. Së fundi, ekipi duhet të ngushtojë dhe të përzgjedhë grupin më të mirë të strategjive nga alternativat duke aplikuar një ose më shumë metoda për përzgjedhjen e strategjisë. Përzgjedhja përfundimtare duhet të përmbushë të paktën këto kritere: *të jetë e lidhur, e fokusuar, e realizueshme dhe e përshtatshme* (shih Aneksin 2),

plus të përfshijë ndikimin e mundshëm të biodiversitetit në lidhje me qëllimet. Përveç kësaj, gjithnjë ka kuptim të zgjidhen strategji që optimizojnë interesat parësorë të aktorëve të interesit, që kufizojnë konfliktet e mundshme ose sigurojnë përkrahjen e aktorëve të interesuar. Ekipet duhet gjithashtu të marrin në konsideratë kritere të tjera të tilla si fizibiliteti (teknike, financiare dhe /ose politike), koston, nishin ose hendekun që strategjia do të përmbushë, si dhe aftësinë për të lëvruar fonde shtesë.

Ju gjithashtu mund të dëshironi të konsideroni disa kritere më shumë se të tjerët. Mbani parasysh se ndoshta do të keni nevojë të merrni disa vendime në lidhje me eliminimet, pasi është e vështirë të identifikohen strategjitë që arrijnë të gjitha kriteret ose që plotësojnë të gjitha interesat tona ose të aktorëve të interesit.

Supozime

Pasi të keni zgjedhur strategjitë tuaja, duhet të keni të qartë mënyrën se si mendoni se secila strategji do t'ju ndihmojë të arrini qëllimet tuaja të ruajtjes. Kjo do të thotë që ju duhet të shprehni qartë supozimet të cilat tregojnë se si besoni se strategjitë tuaja do të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve tuaja të ruajtjes. Zinxhiri i rezultateve është mënyra që përdoret për të përshkruar këto supozime, në një progres shkallë-pasoje ("nëse-atëherë") të rezultateve të ndërmjetme të pritshme afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat çojnë në rezultate⁸ afatgjata të ruajtjes. Ju mund të përdorni modelin tuaj konceptual si bazë për zhvillimin e zinxhirëve të rezultateve (Figura 9). Duke bërë këtë, ju tregoni qartë se si strategjia juaj ka për qëllim të ndikojë në "gjendjen aktuale të botës" (të portretizuar në modelin tuaj konceptual) për t'ju ndihmuar të arrini "gjendjen e dëshiruar të botës" (të portretizuar në zinxhirin tuaj të rezultateve). Shihni në Figurën 10 një shembull real i cili tregon se si një ekip nxori një zinxhir faktorësh nga modeli në Figurën 8 dhe i shndërroi ato në një zinxhir të rezultateve (dhe shtoi objektivat, të përshkruara në seksionin në vijim).



Konsiderata për Ndryshimet Klimatike 1. Identifikimi i strategjive që lidhen me klimën.

Strategjitë potenciale të cilat kanë patur për qëllim të mbështesin targetet e ruajtjes për tu përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike duhet të peshohen kundrejt strategjive të tjera potenciale për të adresuar forcat shtytëse ose kërcënimet jo klimatike.

Si hap i parë ju duhet të identifikoni strategjitë të cilat adresojnë kërcënimet jo klimatike, dhe gjithashtu ndihmojnë targetet të adaptohen ose të përfshihen në një ndikim më të ulët në kuadër të ndryshimeve klimatike të tanishme apo të përshpejtuara. Këto strategji mund të jenë me prioritet të lartë për tu zbatuar.

⁸ Disa njerëz mendojnë se zinxhirët e rezultateve janë të njëjta me kornizat logjike (logframe) ose modelet logjike, por ato ndryshojnë në mënyra të rëndësishme. Kornizat logjike japin një mënyrë të thjeshtë të organizimit të qëllimeve dhe objektivave, por, ndryshe nga zinxhirët e rezultateve, ato nuk lidhin në mënyrë eksplicite strategjitë, objektivat dhe qëllimet. Modelet e logjikës janë më të ngjashme me zinxhirët e rezultateve, por zinxhirët e rezultateve japin një përfitimin shtesë pasi tregojnë më shumë detaje dhe marrëdhënien e drejtpërdrejtë midis një rezultati dhe një tjetëri.

Figura 9. “Faktorët” në një model konceptual të përgjithshëm të asociuar me zinxhirin e rezultateve






Figura 10. Shembull i një zinxhiri rezultatesh për përmirësimin e planifikimit të përdorimit të tokës në një zonë të pellgut ujëmbledhës



Nëse ekipi juaj ka përfshirë targetet e mirëqenies njerëzore në modelin konceptual, ju mund të përdorni zinxhirët e rezultateve gjithashtu për të treguar se si targetet tuaja të ruajtjes ofrojnë shërbime ekosistemi që kontribuojnë në mirëqenien njerëzore (shih Figurën 11 për një shembull të një zinxhiri të rezultateve me targetet e mirëqenies njerëzore). Megjithatë, ju duhet të jeni të qartë se kur veprimet tuaja të ruajtjes po kontribuojnë në objektivat e mirëqenies njerëzore (nëpërmjet shërbimeve të ekosistemit) dhe kur ata kontribuojnë në mënyrë më të drejtpërdrejt përmes një strategjie ruajtje. Shikoni fundin e këtij seksioni në Hapin 2A për një shpjegim më të hollësishëm.

Figura 11. Shembull i një ekstrakti të zinxhirit të rezultateve me targete të mirëqenies njerëzore



Objektivat

Zinxhirët e rezultateve janë gjithashtu një mjet shumë i dobishëm për vendosjen e objektivave afatshkurtra që çojnë në rezultate afatgjata. Objektivat janë deklarime formale të rezultateve (ose rezultateve të ndërmjetme) dhe ndryshimet e dëshiruara që ju mendojnë se janë të nevojshme për të arritur qëllimet tuaja. Objektivat specifikojnë ndryshimet e dëshiruara në faktorët (kërcënimet direkte dhe indirekte dhe mundësitë) që dëshironi të arrini në afat të shkurtër dhe të mesëm. Një objektiv i mirë i plotëson kriteret e të qenit: *i orientuar drejt rezultateve, i matshëm, i kufizuar në kohë, specifik dhe praktik* (Kutia 2).

Kutia 2. Përcaktimi i objektivave "të mira"

Objektivat "e mira" duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- **Të orientuara drejt rezultateve** - Përfaqëson ndryshimet e domosdoshme në kërcënimet kritike dhe/ose faktorët e mundësive që ndikojnë në një ose më shumë targe të ruajtjes ose qëllime të projektit
- **Të matshme** – Të përcaktuar në lidhje me disa shkallë standarde (numra, përqindje, fraksione, ose gjendjen të gjitha/asgjë)
- **Me kohë të kufizuar** – Të arritshëm brenda një periudhe të caktuar kohore, përgjithësisht 3-10 vjet
- **Specifikë** – Të përcaktuar qartë në mënyrë që të gjithë njerëzit e përfshirë në projekt të kenë të njëjtin kuptim për termat që përmban objektivi
- **Praktikë** - Të arritshëm dhe të përshtatshëm brenda kontekstit të zonës së projektit dhe të kontekstit politik, social dhe financiar

Kutia 3. Përcaktimi i objektivave "të mira"

Përveç zbatimit të kriterëve, kur zhvilloni objektivat duhet të merrni në konsideratë edhe sa më poshtë:

- Sqaroni sa shumë ndryshime që duhet të kryeni për të arritur rezultatet e ruajtjes. Ju duhet të sfidoni veten të ktheheni prapa rezultatit tuaj të ndërmjetëm për të përcaktuar se sa duhet të përparojë zinxhiri juaj nga çdo objektiv i mëparshëm.
- Përdorni informacionin ekzistues për të zhvilluar objektivat tuaja. Aty ku është e mundur, është e dobishme të kuptohen kushtet aktuale ose bazë për të përcaktuar se sa ndryshim është i nevojshëm.
- Kuptoni lidhjen dhe ndikimin e objektivave dhe strategjive të tjera. Objektivat tuaja në një zinxhir të vetëm duhet të rrjedhin logjikisht nga njëri-tjetri. Gjithashtu, kini parasysh se strategjitë e tjera (të pasqyruara në zinxhirë të ndryshëm) mund të kontribuojnë në rezultatet e përbashkëta. Kështu, objektivi juaj i përgjithshëm mund të duhet të pasqyrojë ndikimin e strategjive të shumfishta.
- Aty ku është e përshtatshme dhe e mundshme, përdorni modelet teorike dhe inputet e ekspertëve për të vendosur vlerën e numrave në objektivat tuaj (dhe qëllimet).

Siç tregohet në Figurën 10, objektivat tuaja janë të lidhura me rezultatet që dëshironi të shihni për faktorët e ndryshëm në zinxhirin tuaj. Si fillim, gjithmonë duhet të zhvilloni një objektiv për kërcënimin e drejtpërdrejtë në zinxhirin tuaj të rezultateve. Kjo do të orientohet të paktën pjesërisht nga qëllimi që ju keni caktuar për targetin tuaj të ruajtjes. Do të jetë e rëndësishme të punohet me çdo objektiv për të përcaktuar atë që është e përshtatshme dhe për të siguruar që kriteret për objektiva të mira janë përmbushur. Ky është shpesh një proces përsëritës që kërkon rikthim, rafinim dhe qartësim të objektivave me kalimin e kohës.


Qëllimet dhe objektivat e përcaktuara në zinxhirin tuaj të rezultateve përfaqësojnë atë çka ju duhet të përmbushni si dhe supozimet për mënyrën se si

strategjitë tuaja do t'ju ndihmojnë të arrini këto përmbushje. Si të tillë, këto komponentë të zinxhirit të rezultateve shndërrohen në masën përfundimtare kundrejt të cilave ju do të vlerësoni ecurinë e projektit tuaj. Ju duhet të kapni versionet përfundimtare të analizës së situatës tuaj, qëllimet, strategjitë, zinxhirët e rezultateve dhe objektivat në versionin formal të Plan Veprimit tuaj.

Qartësimi i Rezultateve të Dobishme për Shoqërinë dhe Targetet e Mirëqenies Njerëzore

Ne tashmë kemi prezantuar konceptin se si targetet e shëndetshëm të ruajtjes ofrojnë shërbime të ekosistemit të rëndësishme për mirëqenien njerëzore. Përveç kësaj, ekipet e ruajtjes shpesh punojnë në çështje të rëndësishme sociale që kanë përfitime dhe adresojnë interesat përtej ruajtjes (p.sh., ndërtimi i kapaciteteve për qeverisje të mirë ose promovimi i mjeteve të jetesës alternative). Në raste të tilla, strategjia e ruajtjes siguron përfitime sociale. Megjithatë këto përfitime nuk janë ekuivalente me targetet e mirëqenies njerëzore. Ato janë përfitime që rrjedhin nga një strategji që zbatohet në shërbim të ruajtjes. Në të kundërt, targetet e mirëqenies njerëzore përfaqësojnë interesat e njerëzve brenda një rajoni të cilat do të rriten ose arrihen si rezultat i ruajtjes së një ekosistemi, habitati ose speciejve dhe shërbimeve të lidhura me ekosistemin. Për shembull, një ekip projekti mund të zbatojë një strategji eko-çertifikimi për të përmirësuar ruajtjen e pyjeve (Figura 12). Një pjesë e logjikës së strategjisë është rritja e të ardhurave të sharrëxhinjve (ata që presin dru) si nxitje për zbatimin e praktikave të certifikuara dhe përmirësimin e ruajtjes së pyjeve. Rritja e të ardhurave është një rezultat i drejtpërdrejtë (dhe i domosdoshëm) i asaj strategjie, dhe një rezultat prej të cilit përfitojnë njerëzit. Dikush mund ta çojë logjikën edhe më tej dhe të tregojë se si një pyll i ruajtur (qëllimi i fundit i ruajtjes) do të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm me dru (një shërbim ekosistemi) dhe kështu, si shkëmbim, do të kontribuojë në ruajtjen e mirëqenies njerëzore (nëpërmjet një burimi afatgjatë për sigurimin e drurit). Gjithashtu do të ketë përfitime për mirëqenien njerëzore nëpërmjet shërbimeve të tjera të ekosistemit të krijuara nga ruajtja e pyllit - për shembull, sigurimi i ujit të pastër që kontribuon në targetin e mirëqenies njerëzore që lidhet me shëndetin. Edhe pse përmes projekteve të ruajtjes njerëzit mund të përfitojnë drejtpërdrejtë dhe tërthorazi, shpesh ka pengesa që janë të rëndësishme për t'i kuptuar dhe njohur.

Figura 12. Shembull i një strategjie ruajtje prej së cilës njerëzit përfitojnë drejtpërdrejt



Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ◆ **Qëllimet për çdo target të ruajtjes dhe, nëse është e nevojshme, targetet e mirëqenies njerëzore.**
- ◆ **Identifikimi i pikave kryesore të ndërhyrjes dhe projekt strategjive ose paketave të strategjive.**
- ◆ **Prioritizimi i projekt/draft strategjive.**
- ◆ **Zinxhirët e rezultateve që specifikojnë supozimet për strategjitë kyçe.**
- ◆ **Objektivat për rezultatet kyçe të ndërmjetme.**
- ◆ **Strategjitë e finalizuara, zinxhirët e rezultateve dhe objektivat.**
- ◆ **Plani i Veprimit i përfunduar.**

2B. Hartoni një Plan Formal Monitorimi

Ky hap përfshin zhvillimin e një Plani Monitorimi që do të përdoret për të vlerësuar supozimet në zinxhirët e rezultateve dhe për të ndjekur progresin në arritjen e qëllimeve dhe objektive të deklaruara. Plani i Monitorimit do të jetë gjithashtu i dobishëm në identifikimin e burimeve të nevojshme për zbatimin, për përcaktimin e një afati kohor, për grumbullimin dhe analizën e të dhënave dhe për një pasqyrim të rreziqeve potenciale që duhet të konsideroni.

Audienca dhe Nevojat për Informacion

Pjesa e parë e zhvillimit të Planit të Monitorimit përfshin përcaktimin e audienës dhe nevojave të tyre për informacion. Monitorimi efektiv përdor sasinë minimale të burimeve financiare dhe njerëzore për t'ju siguruar informacionin minimal të besueshëm dhe të nevojshëm për të përcaktuar nëse projekti juaj është në rrugën e duhur për të arritur objektivat e deklaruara dhe çfarë duhet të bëni nëse nuk është kështu. Si hap i parë, duhet të përcaktoni se për kë po bëni monitorimin, çfarë do të donin ata të dinin dhe nivelin e rreptësisë që nevojitet për të kënaqur nevojat e tyre.

Për shembull, një audiencë për monitorimin tuaj mund të jenë menaxherët ose mbështetësit financiarë kundrejt të cilëve ju jeni përgjegjës për projektin. Ndoshta audiencia më e rëndësishme, është ekipi juaj i projektit. Në frymën e menaxhimit adaptiv, ju duhet ta kryeni monitorim për të ndihmuar ekipin tuaj që të vlerësojë supozimet në zinxhirët e rezultateve tuaja, të dokumentojë arritjet objektive dhe të mësonjë nga informacionet e mbledhura në një mënyrë që mund t'i integrojë në programimin aktual dhe të ardhshëm. Tabela e mëposhtme rendit disa audiencia të zakonshme dhe nevojat e tyre të përgjithshme për informacion.

Tabla 1. Audiencia të zakonshme monitorimi dhe nevojat e tyre për informacion

Audiencia	Nevojat/Interesat tipike për informacion
Ekipi i projektit	Si po përparon projekti? A janë të vlefshme supozimet e zinxhirëve të rezultateve; Çfarë po funksionon, çfarë nuk po funksionon dhe pse? A është duke arritur objektivat në kohën e pritshme ekipi juaj; Si të përmirësohet projekti
Partnerët e projektit	Si po përparon projekti; A janë të vlefshme supozimet e zinxhirëve të rezultateve; Çfarë po funksionon, çfarë nuk po funksionon dhe pse? A është duke arritur objektivat në kohën e pritshme ekipi juaj; Si të përmirësohet projekti

Audienca	Nevojat/Interesat tipike për informacion
Donatorët	Si po përparon projekti, a po i arrijnë projektet objektivat në kohën e pritshme
Komunitetet ose aktorët e interesit të prekur	Si po ecën projekti; Si do t'i ndikojë projekti
Komuniteti i ruajtjes	A i arriti projekti objektivat dhe rezultatet e ruajtjes; çfarë ka funksionuar, çfarë nuk ka funksionuar dhe pse
Akademikët dhe studentët	Çfarë po funksionon, çfarë nuk po funksionon dhe pse
Auditorët, entitetet e çertifikimit	A është projekti në përputhje me ligjet dhe rregulloret; A po ndjek praktikën më të mira

Pasi ta dini për kë do të monitoroni, atëherë duhet të identifikoni atë që doni të dini (pyetjet e të nxënësve) dhe atë që duhet të monitoroni. Duke i përqendruar përpjekjet tuaja të monitorimit drejtpërdrejt në supozimet kryesore që keni bërë në projektin tuaj (të ilustruar në zinxhirët e rezultateve tuaja që lidhen me qëllimet, objektivat dhe strategjitë tuaja), ju keni më shumë gjasa të grumbulloni vetëm informacionin që do të jetë i dobishëm për ju dhe audiencën tuaj të monitorimit ndërsa menaxhoni projektin tuaj.

Indikatorët

Pasi të keni identifikuar audiencën dhe nevojat e saj për informacion, hapi tjetër është të zhvilloni indikatorët specifikë që do të përdorni për të grumbulluar dhe analizuar të dhënat e nevojshme për të plotësuar nevojat tuaja të informacionit. Indikatorët e mirë përmbushin kriteret: të jenë *të matshëm, të saktë, konsistent* dhe *të ndjeshëm* dhe duhet të lidhen qartë me rezultatet dhe objektivat e ndërmjetme (shih Aneksin 2).

Zinxhirët e rezultateve tuaja, së bashku me qëllimet dhe objektivat e tyre përkatëse ju ofrojnë bazën për identifikimin e asaj që ju duhet të matni dhe cilët indikatorë duhet të përdorni. Duke zhvilluar zinxhirët e rezultateve dhe duke vendosur qëllime dhe objektiva të mira, ju keni zvogëluar grupin e pafund të indikatorëve të mundshëm në një numër shumë të menaxhueshëm. Figura 13 tregon se si indikatorët e përgjithshëm janë të lidhur me një zinxhir rezultatesh, ndërsa Figura 14 jep një shembull konkret se si zinxhirët e rezultateve mund t'ju ndihmojnë të zvogëloni numrin e indikatorëve tuaj. Mos harroni, ju duhet të synoni të grumbulloni informacionin më të vogël për të sqaruar supozimet në zinxhirët tuaj të rezultateve dhe për të treguar progresin drejt arritjes së objektivave të deklaruar. Kështu,



Konsiderata për Ndryshimet Klimatike 7. Monitorimi i Efekteve dhe Strategjive të Ndryshimeve Klimatike

Për shkak se ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe efektiviteti i strategjisë klimatike ende përfshijnë pasiguri, është e rëndësishme të siguroheni se plani juaj i monitorimit përfshin masa për të ulur këtë pasiguri. Masat tuaja mund të përqendrohen në ndryshimet aktuale të klimës, ndikimet ekologjike të këtyre ndryshimeve dhe/ose efektivitetin e strategjive të ndryshme të adaptimit.

Përveç kësaj, ju mund të dëshironi të përfshini masa për të identifikuar një prag që do t'ju ndihmojë të përcaktoni kur është e përshtatshme për të ndërmarrë strategji që janë më drastike ose më të shtrenjta

për pjesën më të madhe, ju do të doni që të kufizoni indikatorët që monitoroni tek ata indikatorë që korrespondojnë me zinxhirët e rezultateve tuaja. Megjithatë, mund të ketë faktorë të rëndësishëm që janë jashtë kontrollit të strategjisë suaj, por që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në suksesin e strategjisë suaj (p.sh., situata politike ose forcat e tregut). Në këto raste, ju mund të dëshironi të monitoroni këta faktorë me një grup të kufizuar indikatorësh për t'ju ndihmuar të kuptoni më mirë se në çfarë shkalle po i arrini rezultatet e pritura në zinxhirin tuaj të rezultateve. Gjithashtu, duhet të jeni i hapur për "monitorim" ose rishikimin e planit tuaj të monitorimit me kalimin e kohës, për t'u siguruar që po plotëson nevojat e informacionit të ekipit tuaj dhe audiencës tuaj të monitorimit.

Figura 13. Një zinxhir rezultatesh i përgjithshëm me indikatorë





Figura 14. Zinxhir rezultatesh me indikatorët potencial gjatë planifikimit të përdorimit të tokës



Metodat

Ndërsa jeni duke zhvilluar indikatorët tuaj, do t'ju duhet të mendoni se si do t'i matni ata - me fjalë të tjera, cilat metoda do të përdorni. Metodat duhet të plotësojnë kriteret që të jenë të *sakta, të besueshme, me kosto efektive, të realizueshme dhe të përshtatshme* (shih Aneksin 2). Çështja kryesore është që të zgjidhni metodën me kosto më efektive që do t'ju japë të dhëna të besueshme dhe të mjaftueshme për të përmbushur nevojat tuaja të menaxhimit. Për informacionin që ju nevojitet, mund të mos duhet të mblidhni të dhëna të reja eksplicite për projektin. Për shembull, një metodë për grumbullimin e të dhënave për një popullsi të caktuar peshku do të ishte "të shkarkosh regjistrimet e prodhimit të vendosura nga një agjenci qeveritare në internet". Megjithatë, në disa raste, do të kërkohet grumbullim i të dhënave paraprake. Së fundi, duhet gjithashtu të përcaktoni afërsisht se kur, ku dhe nga cilët do ti grumbulloni të dhënat, si ato do të analizohen dhe përdoren për të përmbushur nevojat për informacion të audiencave tuaja kryesore (shih Tabelën 2 për një model të një plani monitorimi). Gjatë zhvillimit të Planit të Monitorimit, është më mirë të testoni dhe përshtatni indikatorët dhe metodat përpara se t'i përdorni ato. Gjithashtu duhet të planifikoni se si do të ruani dhe përpunoni çdo lloj të dhëne paraprakisht dhe buxhetin formal për aktivitetet e monitorimit në planifikimin tuaj të përgjithshëm financiar (Shihni Hapin 3 dhe Hapin 4 për më shumë informacion rreth menaxhimit të të dhënave dhe buxhetimit për monitorim).

Tabla 2. Ekstrakt i një plani monitorimi

Item	People	Timeframe	Measurement Date	Measurement Value	Trend	Source
Qëllimi. Korridore pyjore të shëndetshëm						
▲ Qëllimi/a. Gjerësia minimale e korridorit pyjor në kilometra			2013-03-25	2.25 km	Flat	Rapid Assessment
▲ Qëllimi/b. Dëshmitë e fragmentimit të korridorit			2013-03-25	4 zona ku korridori është i prishur	Mild Increase	Not Specified
● Analizoni imazhet satelitore	AM, JB	FY15				
LUP1. Ruajtja e rregullave të zonave miqësore të zhvilluara						
▲ LUP1. Miratimi i rregulloreve të zonimit që përfshijnë një moratorium mbi lejet e reja të ndërtimit në zonat miqësore			2013-03-25	Under review	Not Specified	Not Specified
● Rishikimi i procesverbalit të Këshillit Bashkiak	LS	Q1 FY14				
● Rishikimi i përditësimeve të rregulloreve të botuara	LS	Q1 FY14				
LUP2. Ruajtja e rregullave të zonave miqësore të zbatuara						
▲ LUP2. % e lejeve të reja të ndërtimit që shmangin zhvillimin në zonat unike të listuara në shtet			2013-03-25	70%	Mild Increase	Expert Knowledge
● Konsultime me planifikuesin e qarkut	LS	Q4 FY16 - Q4 FY20				
LUP3. Zvogëlimi i hapësirave për ndërtimin e shtëpive të reja						
▲ LUP3. # e shtëpive të reja në procesin e lejes, planifikimit ose ndërtimit në zonat unike të identifikuara			2013-03-25	25	Mild Increase	Expert Knowledge
● Konsultime me planifikuesin e qarkut	LS	Q4 FY16 - Q4 FY20				
● Vizitat në terren						

Çelësi

○ Qëllim □ Objektiv ▲ Indikator ● Metoda

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë një plan formal monitorimi që përmban:

- ◆ **Përcaktim i qartë i audiencave dhe nevojës që ato kanë për informacion.**

- ◆ **Përcaktimi i indikatorëve dhe metodave.**
- ◆ **Plani final i monitorimit.**

2C. Hartoni një Plan Operacional

Projektet e ruajtjes zbatohen përfundimisht nga njerëzit dhe institucionet. Por, nëse nuk i vendosni në veprim, edhe aktivitetet dhe planet e monitorimit më të mira, nuk janë të dobishëm. Me fjalë të tjera, keni nevojë për një Plan Operacional për projektin tuaj. Komponentët kryesorë për një plan operacional përfshijnë analizën për:

- Mjetet financiare të nevojshme për zbatimin e projektit dhe një llogaritje e burimeve tuaja aktuale dhe potenciale të këtyre fondeve.
- Kapacitetet dhe aftësitë njerëzore dhe burime të tjera jo financiare që ju duhen për të zbatuar projektin tuaj dhe çfarë duhet të bëni për të zhvilluar këto burime, duke përfshirë ngritjen dhe mbajtjen e partneriteteve.
- Cilët janë faktorët e rrezikut për projektin tuaj dhe si mund të adresohen ata. Një faktor rreziku është një ngjarje ose gjendje pasigurie e cila, nëse ndodh, ka një efekt negativ në të paktën një element të projektit, siç është koha, kostoja, fushëveprimi ose cilësia. Një vlerësim i rrezikut duhet të vlerësojë si probabilitetin që faktori i rrezikut mund të ndodh ashtu edhe ndikimin ose ashpërsinë e faktorit të rrezikut nëse ai ndodh. Qëllimi i vlerësimit të rrezikut është identifikimi i çështjeve që potencialisht mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e projektit për të zbatuar në mënyrë efektive strategjitë kryesore dhe/ose për të arritur qëllimet e ruajtjes dhe për të identifikuar strategji shtesë të nevojshme për të zbutur ose shmangur ato rreziqe.
- Sa gjatë do të zgjasë projekti juaj, si do të siguroni qëndrueshmërinë e arritjeve të projektit dhe cila do të jetë strategjia juaj e daljes (përfundimtare).

Dy komponentët e parë në të vërtetë formojnë planin tuaj të punës dhe buxhetin, të cilat janë shtjelluar më hollësisht në Hapin 3. Niveli i detajeve dhe formalitetit të planit tuaj operacional do të ndryshojë në varësi të madhësisë dhe nivelit të kompleksitetit të projektit tuaj. Projektet e vogla mund të prekin shkurtimisht secilën nga këto tema, ndërsa ato të mëdha dhe komplekse mund të kenë një trajtim të gjerë dhe formal të secilit.

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë një plan operacional që përmban:

- ◆ **Vlerësimin e burimeve njerëzore, financiare dhe burimeve të tjera.**
- ◆ **Vlerësimin e rrezikut dhe mitigimin.**
- ◆ **Llogaritjen e jetëgjatësisë dhe strategjisë përfundimtare.**

Në përfundim të hapit 2, ju do të keni të gjitha produktet e një plani strategjik. Në varësi të nevojave tuaja, ju mund ta hartoni këtë informacion si një plan formal. Ose, nëse po përdorni softuer si Miradi, mund të jetë e mjaftueshme që ta përdorni skedarin (file) tuaj si planin tuaj "të gjallë".

3. Zbatoni Aktivitetet dhe Monitorimi

Ky është hapi më i rëndësishëm në të gjithë procesin e ciklit të menaxhimit adaptiv. Është koha në të cilën ju zbatoni planin që e keni hartuar në hapat e mëparshëm. Ky hap përfshin hartimin dhe zbatimin e planeve të punës specifike duke siguruar burime, kapacitete dhe partnerë të mjaftueshëm.

3A. Hartoni një plan pune të detajuar aftashkurtër dhe një plan kohor

Në hapat e mëparshëm të ciklit të projektit, ekipi i projektit tuaj ka hartuar aktivitetet tuaja të përgjithshme, monitorimin dhe planet operationale. Në këtë fazë të ciklit, ju duhet t'i ktheni këto plane të përgjithshme në plane më specifike dhe pastaj t'i zbatoni këto plane në mënyrë të vazhdueshme.

Pjesa e parë e këtij hapi është që të merrni planet tuaja të përgjithshme dhe të punoni me ekipin tuaj të projektit dhe partnerët për të hartuar një plan pune shumë më specifik afatshkurtër që mbulon muajt e ardhshëm ose më së shumti, vitin. Ky plan pune përdor planin tuaj të përgjithshëm të veprimt, monitorimin dhe planet operationale për t'i specifikuar në detaje shumë më të hollësishme:

- **Çfarë** aktivitetesh dhe detyra specifike janë të nevojshme për të plotësuar çdo strategji të planifikuar, çdo hap monitorimi, ose funksion operacional,
- **Kush** do të jetë përgjegjës dhe kush do të japë llogari për përfundimin e çdo aktiviteti dhe detyre,
- **Kur** do të ndërmerret çdo detyrë dhe si do të jetë sekuenca e aktiviteteve dhe detyrave që lidhen me njera-tjetrën, dhe
- **Sa** para dhe burime të tjera do të nevojiten për të përfunduar çdo aktivitet dhe detyrë (shih Hapin 3B për detaje më të hollësishme).

Plani juaj i detajuar i punës do t'ju ofrojë bazën për zhvillimin e një plani kohor ose kalendari të projektit. Në disa situata, plani juaj i punës nuk do të specifikojë vetëm detyrat dhe përgjegjësitë, por gjithashtu do të plotësojë në kalendar kohën se kur këto detyra do të zhvillohen. Në situata të tjera, afati kohor ose kalendari juaj do të jetë më i brendshëm. Është e rëndësishme të planifikoni kohën tuaj në mënyrë që të gjithë anëtarët e ekipit të projektit të buxhetojnë kohën e tyre sipas nevojave të projektit. Plani juaj i punës do t'ju ndihmojë gjithashtu të identifikoni se cilët anëtarë të ekipit të projektit mund të kenë kohë për të punuar me të dhe cilët janë të mbingarkuar. Ky informacion është gjithashtu i rëndësishëm për të hartuar buxhetin e projektit.

Ndërsa projekti juaj është në zbatim e sipër, ju duhet të rishikoni dhe përditësoni planin e punës, përsëri duke u fokusuar në aktivitetet e detajuara për muajt e ardhshëm apo më shumë.

Ju mund ta hidhni planin tuaj të punës në një tabelë, tabelë Gantt, dhe/ose në një kalendar projekti. Figura 15 tregon një shembull të një tabele (të zhvilluar në Miradi) e cila përfshin si një plan pune ashtu edhe një buxhet (shih Hapin 3B).

Figura 15. Plani i Punës dhe Ekstrakti i Buxhetit për një Vend Detar

Item	Progress	Work Assignments			Work Units			Projected Expenses			Budget Totals		
		Who	When		2012	2013	Total	2012	2013	Total	2012	2013	Total
Marine Site	Not Specified	JH, EM, GdR, MIM, AT, LE2, LE, Not Specified			845	579	1424	99,500	66,500	171,000	275,450	149,650	430,100
1. Fushata për të ndaluar përdorimin e supes së peshqazënit	Not Specified	JH, EM, GdR, AT, MIM, Not Specified			360	152	512	5,000	3,000	13,000	50,050	19,750	74,800
1. Fushata për të ndaluar supen e peshqazënit	Scheduled	AT, EM, GdR, JH, MIM, Not Specified	Q1 FY12 - Q4 FY...		360	152	512	5,000	3,000	13,000	50,050	19,750	74,800
Kerkim për ndikimin lokal të peshkimit të peshqazënit	Scheduled	JH, MIM	2012-02-01 - 201...		101		101	5,000		5,000	15,100		15,100
Planifiko fushatën me CAI	Scheduled	AT, EM, GdR, JH, MIM	Q1 FY12 - Q2 FY...		62		62			5,000	14,200		19,200
Përgatit materialet për restorantet dhe konsumatorët	Scheduled	AT, MIM	Q2 FY12 - Q3 FY...		50		50				4,500		4,500
Zbato fushatën (radio, TV, print)	Scheduled	AT, EM, MIM	Q3 FY12 - Q4 FY...		95	100	195				8,500	9,000	17,500
Vlereso arritjen dhe përthithjen e mesazhit	Scheduled	AT, JH	Q4 FY12 - Q4 FY...		25	25	50				2,250	2,250	4,500
Përshtat fushatën sipas nevojave	Scheduled	AT, EM, GdR, JH, MIM	Q4 FY12 - Q4 FY...		27	27	54				5,500	5,500	11,000
2. Promovimi i teknikave të qëndrueshme të peshkimit	Not Specified	JH, EM, GdR, AT, MIM, Not Specified			375	375	750	10,000		10,000	68,500	58,500	127,000
Not Specified	Not Specified	JH, EM, GdR, MIM			65	12	77				13,900	3,900	17,800
3. Promovimi i teknikave të mitigimit për derdhjet	Scheduled	EM, GdR, JH, MIM	Q1 FY12 - Q4 FY...		65	12	77				13,900	3,900	17,800
Përpilo informacionin për fonde për mitigimin e derdhjeve	Scheduled	EM, GdR	Q1 FY12 - Q3 FY...		7	12	19				2,100	3,900	6,000
Identifiko anije potenciale	Scheduled	EM, JH	FY12		10		10				1,250		1,250
Kerko dhe identifiko praktikant me të mira të mitigimit për derdhjet	Scheduled	EM, GdR, JH	FY12		12		12				2,150		2,150
Kontaktë fillestar individual me pronarët e anijeve	Scheduled	GdR, JH, MIM	Q2 FY12 - Q3 FY...		21		21				4,900		4,900
Zhvillo seri workshopesh me pronarët e interesuar të anijeve	Scheduled	EM, GdR, JH, MIM	FY12		15		15				3,500		3,500
4. Forcimet zbatimi i ligjit	Not Specified	GdR, LE2, LE			10	0	10	35,000	25,000	60,000	90,000	25,000	115,000
Forcimi i zbatimit të ligjit	Scheduled	GdR, LE2, LE	Q1 FY12 - Q4 FY...		10	0	10	35,000	25,000	60,000	90,000	25,000	115,000
5. Kosto të tjera	Not Specified							49,500	38,500	88,000	49,500	38,500	88,000
Kosto operacionale	Not Specified							36,000	25,000	61,000	36,000	25,000	61,000
Transporti dhe shpenzime të tjera	Not Specified							13,500	13,500	27,000	13,500	13,500	27,000
Aktivitetet e monitorimit të migrimit	Not Specified	JH, Not Specified			35	40	75				3,500	4,000	7,500
Aktivitetet të monitorimit të migrimit (shiko Detajet)	Not Specified	JH, Not Specified	Q1 FY12 - Q4 FY...		35	40	75				3,500	4,000	7,500
CORAL2. Masa e dendimit nga shpërthimet të shkëmbinjve koralore në	Not Specified	Not Specified	Q1 FY12 - Q4 FY...										
SGRASS. Zona me shtratin e posidonias	Not Specified	Not Specified	Q1 FY12 - Q4 FY...										
SHARK. Nr i peshqazëneve në Gj	Scheduled	JH	Q1 FY12 - Q4 FY...		10	15	25				1,000	1,500	2,500
SUST2. % e peshqazëneve artizanale që përdorin teknikat	Scheduled												
SHARK1. # i incidenteve në vit nga peshkimi i ligjshëm i peshqazëneve me	Scheduled	JH	Q1 FY12 - Q4 FY...		5	5	10				500	500	1,000
SHARK1a. % e restorantëve të peshkut që janë pjesëmarrës aktiv në	Scheduled	JH, Not Specified	Q1 FY12 - Q4 FY...		10	10	20				1,000	1,000	2,000
SHARK1b. % e konsumatorëve të analizuar në tregjet urbane që mudi	Scheduled	JH	Q1 FY12 - Q4 FY...		10	10	20				1,000	1,000	2,000

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ◆ **Plani i punës që detajon detyrat, aktivitetet dhe përgjegjësitë që lidhen me Planin tuaj të Veprimit, Planin e Monitorimit dhe Planin Operacional**
- ◆ **Një plan kohor apo kalendar i projektit.**

3B. Zhvilloni dhe Përmirësoni Buxhetin e Projektit tuaj

Pasi të dini saktësisht se cilat detyra dhe aktivitete duhet të ndërmerrni, do të jeni në një pozitë më të mirë për të kuptuar se për çfarë burimesh keni nevojë. Ju duhet të lini mënjatë analizën fillestare të nevojës për mbulim financiar që ju zhvilluat gjatë planit operacional (Hapi 2C). Kjo, së bashku me planin tuaj strategjik dhe planin tuaj të punës, do t'ju ndihmojë të llogarisni më mirë shpenzimet për aktivitete dhe detyra specifike si dhe strategjitë më të gjera për të cilat duhen këto detyra. Plani juaj i punës do të jetë një kontribut i rëndësishëm për këtë proces, por duhet të mbani parasysh se ai është afatshkurtër, kështu që do t'ju duhet të bëni disa llogaritje të bazuara në informacionin që keni për të parashikuar kostot e mundshme gjatë projektit. Ju nuk duhet të vonoheni, duke shpresuar që do të keni llogaritje më të sakta, pasi shpesh ka një kohë të gjatë midis hartimit të buxhetit të propozuar dhe marrjen e parave në llogarinë bankare për ti shpenzuar ato. Kështu, ju do të keni nevojë të hartoni buxhetin e projektit menjëherë sapo të keni një ide të qartë se çfarë do të bëjë projekti juaj (me fjalë të tjera, një draft i mirë i planit tuaj strategjik).

Ju duhet të punoni ngushtë me stafin e financave ose të kontabilitetit në zyrën tuaj për të zhvilluar buxhetin e projektit. Për shumë projekte, burimet më të shtrenjta do të jenë koha e stafit. Përveç kësaj, duhet të konsideroni se cilat shpenzime të tjera të mëdha, siç janë infrastruktura fizike, automjetet, anijet ose makineritë, janë të nevojshme. Ju gjithashtu duhet të konsideroni funksionet përkatëse ose mbështetjen logjistike që mund të ketë nevojë projekti, duke filluar nga shpenzimet e monitorimit dhe menaxhimit, deri tek ato administrative ose logjistike. Në një qasje të menaxhimit adaptiv, ekipi juaj duhet të monitorojë se si shkojnë gjërat, në mënyrë që të dijë se çfarë ecën dhe çfarë jo, si dhe kur duhet të rregullojë ecurinë e tyre. Kështu, aktivitetet e monitorimit duhet të reflektohen qartë si në planin e punës ashtu edhe në buxhet.

Sapo të keni hartuar buxhetin e projektit, do t'ju duhet të identifikoni burimet potenciale të financimit si dhe të zhvilloni e dorëzoni propozime tek donatorët e mundshëm. Në mënyrë ideale, do të kërkonti dhe fitoni fonde për strategjitë prioritare më të larta në fillim. Në realitet, mund t'ju duhet të përshtateni me mundësitë dhe kufizimet që ju shfaqen dhe mund të vini re se financimi juaj fillestar fokusohet në disa strategji prioritare të mesme ose të ulëta. Kjo është sërish mirë për sa kohë që ju nuk i harroni strategjitë tuaja me prioritet të lartë dhe punoni për t'i zbatuar ato sa më shpejt që të jetë e mundur.

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ◆ ***Buxheti i projektit.***
- ◆ ***Identifikohen burimet potenciale financiare.***
- ◆ ***Hartohen dhe dorëzohen propozimet financiare.***
- ◆ ***Sigurohen burimet financiare.***

3C. Zbatoni planet tuaja

Pjesa tjetër dhe më e rëndësishme e Hapi-t 3 - dhe në të vërtetë i të gjithë këtij procesi - është të zbatoni planin tuaj strategjik dhe planin tuaj më të detajuar të punës sipas planifikimit kohor dhe

brenda buxhetit. Kjo përfshin zbatimin e aktiviteteve dhe monitorimin e vazhdueshëm. Në këtë pikë, mund të jetë e dobishme të përdorni mjete/mënyra për matur progresin e projektit, sa afër apo larg jeni nga zbatimi i aktiviteteve apo përmbushja e detyrave të nevojshme për të zbatuar planin tuaj strategjik.

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ♦ ***Në përgjithësi, zbatimi i planit strategjik (veprimi, monitorimi dhe planet operative).***
- ♦ ***Më konkretisht, zbatimi i planit tuaj të punës, duke mbajtur parasysh buxhetin dhe afatet kohore të projektit***

4. Analizoni, Përdorni, Përshtasni

Ky hap përfshin menaxhimin e të dhënave nga momenti kur i merrni ato në analizimin e vazhdueshëm të tyre për t'i kthyer në informacion të dobishëm. Në veçanti, ju duhet të analizoni rezultatet e projektit dhe supozimet kryesore, si dhe të dhënat operative dhe financiare, dhe pastaj të përshtasni planet tuaja të punës sipas nevojës. Koha që nevojitet për të përfunduar këtë hap shpesh nënvlerësohet nga menaxherët e projektit, duke i lënë ata në një situatë ku kanë shumë informacione të mbledhura por të paanalizuara ose të papërdorura. Nivelet e kompleksitetit në analizë variojnë nga shumë të thjeshta dhe të shpejta në shumë intensive në kohë dhe komplekse. Ashtu si në përzgjedhjen e metodave të monitorimit, duhet të siguroheni se niveli juaj i analizës përputhet me nivelin minimal të evidencave të besueshme të kërkuara nga situata dhe nevojat për informacion të audiencës. Duke e bërë këtë një hap të qëllimshëm, ju duhet ta keni më të lehtë për të vëzhguar dhe kuptuar ndryshimet, për të zgjidhur problemet dhe për të bërë përmirësime në projektin tuaj.

4A. Përgatisni të dhënat tuaja për analizë

Analiza është një proces i transformimit të të dhënave të papërpunuara në informacion të dobishëm. Analiza nuk duhet të kryhet vetëm në një moment gjatë jetës së projektit. Për të kuptuar vazhdimisht se çfarë po ndodh në projektin tuaj - dhe për të qenë në gjendje të ndryshoni gjërat në kohën e duhur - është thelbësore të kapni dhe analizoni të dhënat tuaja monitoruese si pjesë e punës rutinë gjatë projektit.

Për ta bërë këtë, duhet të keni sisteme të sigurta të menaxhimit të të dhënave. Idealisht, këto janë të lidhura ose komunikojnë në një farë mënyre me atë që keni parashtruar në planin tuaj strategjik. Për shembull, nëse po grumbulloni të dhëna se sa leje të reja ndërtimi lëshohen për zonat unike të renditura në shtet (referojuni figurës 10 dhe figurës 14), sistemet tuaja duhet t'ju lejojnë të verifikoni lehtësisht se qëllimi juaj ishte të mos kishte leje të reja ndërtimi të lëshuara në këto zona dhe që ju presni ta shihni këtë deri në vitin 2016.

Përveç kësaj, ju duhet të keni të ngritura metoda dhe sisteme për regjistrimin, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave. Kjo përfshin proceset për kontrollin sistematik, për pastrimin dhe kodimin e të dhënave të papërpunuara, dhe për ruajtjen dhe krijimin e një kopje rezervë të dhënave tuaja. Kjo punë duhet bërë si për të dhënat programatike edhe për të dhënat operative dhe financiare.

Produkti për këtë praktikë të standardit përfshin:

- ♦ ***Zhvillimi dhe përdorimi i sistemeve për regjistrimin, magazinimin, procesimin dhe krijimin e një kopje rezervë të të dhënave të projektit.***

4B. Analizoni Rezultatet

Një nga aspektet më të rëndësishme të menaxhimit adaptiv është se ju lejon të vlerësoni në mënyrë sistematike nëse jeni në rrugën e duhur për të arritur qëllimet dhe objektivat tuaja të deklaruara. Të dhënat tuaja të monitorimit duhet t'ju japin informacionet e nevojshme për të parë nëse keni arritur rezultatet e pritshme të ndërmjetme dhe nëse jeni në rrugën e duhur për të arritur sukses afatgjatë. Përveç kësaj, menaxhimi adaptiv gjithashtu ju lejon të përcaktoni se përse disa aktivitete kanë qenë të suksesshme ose kanë dështuar. Të dhënat tuaja të monitorimit ju japin mundësinë për të parë nëse supozimet kryesore që ju keni paraqitur në hapat e planifikimit të mësipërm qëndrojnë të vërteta në realitet. Duke testuar këto supozime thelbësore, ju jeni në një pozicion më të mirë për të përshtatur dhe ndryshuar aktivitetet e projektit tuaj në përputhje me rrethanat.

Për të mësuar dhe për të patur një komunikim efektiv, është e rëndësishme që njerëzit e duhur të përfshihen në analiza dhe/ose të bëhen të vetëdijshëm për rezultatet e analizave. Si rregull i përgjithshëm, analizat duhet të përfshijnë anëtarë të ekipit të projektit. Sidoqoftë, kontributi i ekspertëve të jashtëm ose atyre me perspektiva të tjera është i vlefshëm gjatë analizës së rezultateve tuaja të monitorimit.

Për të kontrolluar nëse jeni në rrugën e duhur ose pse diçka mund të ketë sukses ose të ketë dështuar, duhet të ndërmerrni detyrat e mëposhtme:

- Merrni parasysh rezultatet tuaja në kontekstin e modelit tuaj konceptual dhe zinxhirëve të rezultateve;
- Rishikoni supozimet tuaja dhe vlerësoni nëse ato janë të sakta, nëse jeni në rrugën e duhur për të përmbushur qëllimet dhe objektivat tuaja dhe nëse strategjitë tuaja kanë ndikimin e dëshiruar;
- Po ashtu, rishikoni modelin tuaj konceptual dhe përcaktoni nëse ka faktorë të rëndësishëm që nuk i keni përfshirë ose monitoruar dhe që mund të ndikojnë në aftësinë tuaj për të pasur sukses;
- Vlerësoni dobinë e indikatorëve tuaj;
- Përcaktoni nëse qëllimet dhe objektivat tuaja ishin vendosur në nivelin e duhur dhe nëse afati kohor për arritjen e tyre ishte i përshtatshëm;
- Identifikoni dhe dokumentoni pyetjet tuaja të të nxënit, si dhe çdo gjë që keni mësuar, ndërsa zbatoni projektin tuaj.

Në varësi të llojit të të dhënave që keni dhe nevojave për informacion, këto analiza mund të variojnë nga studimet formale statistikore në vlerësime të thjeshta cilësore. Është gjithashtu e rëndësishme të shqyrtohet nëse proceset operationale që mbështesin projektin tuaj funksionojnë siç duhet. Ju mund të keni një projekt që përdor strategjitë e përsosura për të adresuar kërcënimet dhe mundësitë që ndikojnë në objektivat tuaja të ruajtjes, por ndoshta ekipi juaj nuk funksionon në mënyrë efikase ose nuk ka mbështetjen e duhur administrative ose financiare që të kryejë mirë punën e vet. Disa pyetje që mund të dëshironi të shqyrtoni gjatë analizës suaj përfshijnë:

- Deri në çfarë mase keni burime të mjaftueshme (p.sh., financiare, njerëzore, administrative, politike) për të kryer projektin tuaj?
- Deri në çfarë mase keni aftësitë e duhura midis anëtarëve të ekipit tuaj për të zbatuar mirë projektin tuaj?
- Deri në çfarë mase keni infrastrukturë dhe pajisje fizike (p.sh., hapësirë për zyrë, automjete, kompjutera) që ju duhen për të kryer punën tuaj?
- Deri në çfarë mase ekipi juaj i projektit funksionon pa probleme apo a ka fusha ku mund të përmirësoni funksionimin e ekipit (p.sh., komunikimet, delegimi i përgjegjësisë)?

Produktet për këtë praktikë të standardeve përfshijnë:

- ◆ ***Analizë e rezultateve të projektit dhe supozimet.***
- ◆ ***Analizë e të dhënave operacionale dhe financiare.***
- ◆ ***Dokumentim i diskutimeve dhe vendimeve.***

4C. Përshtasni planin tuaj strategjik

Mbledhja dhe analizimi i të dhënave si pjesë e aktiviteteve monitoruese rutinë ju lejon të përcaktoni sa efektive janë ndërhyrjet tuaja dhe çfarë duhet të bëni për ta përshtatur projektin për të arritur qëllimet dhe objektivat tuaja në mënyrë më efikase. Si pjesë përfundimtare e këtij hapi, duhet të përdorni atë që keni mësuar gjatë analizave dhe diskutimeve për të modifikuar dhe optimizuar aktivitetet tuaja. Ky është thelbi i menaxhimit adaptiv.

Të gjitha planifikimet që keni bërë më parë nuk kanë për qëllim që të jenë një kapitull i mbyllur në kohë, që kurrë të mos rishqyrtohen ose të përdoren përsëri. Përkundrazi, në mënyrë që të vazhdoni të mësoni me kalimin e kohës dhe të vazhdoni të përmirësoni efektivitetin e projektit tuaj, ju duhet të rishikoni dhe përshtasni parametrat tuaj të projektit dhe supozimet kryesore, planin e veprimit, planin e monitorimit, planin operacional, planin e punës dhe buxhetin. Prandaj, mund t'ju duhet të përditësoni shumë ose të gjitha pjesët e planit tuaj strategjik për të pasqyruar atë që keni mësuar. Ndërsa bëni ndryshime, gjithashtu duhet të dokumentoni arsyetimin që qëndron prapa këtyre ndryshimeve në mënyrë që të tjerët ta kuptojnë atë që keni mësuar dhe pse i keni bërë këto ndryshime. Kjo gjithashtu do të jetë një kontribut i rëndësishëm për Hapin 5 (Ruajtja dhe ndarja e të nxënit).

Kur përditësoni planin tuaj strategjik, duhet gjithashtu të inkorporoni gjetjet nga analizat e bëra jashtë ekipit tuaj të projektit. Për shembull, nëse projekti juaj i është nënshtruar një vlerësimi ose auditimi formal (shih Hapin 5C), duhet të ekzaminoni gjetjet dhe të shihni se si mund t'i përdorni ato për ta përshtatur dhe përmirësuar projektin dhe planin tuaj strategjik. Në mënyrë të ngjashme, ju duhet të jeni të informuar për gjetjet e rëndësishme nga puna kërkimore, njohuritë e reja dhe inovacionet të cilat mund t'ju ndihmojnë të përmirësoni punën tuaj në projekt.

Produkti për këtë praktikë të standardit përfshin:

- ◆ ***Dokumentet e rishikuara të projektit (duke përfshirë planin e veprimit, planin e monitorimit, planin operacional, planin e punës dhe buxhetin).***
- ◆ ***Dokumentimi i diskutimeve dhe vendimeve të marra.***

5. Ruajtja dhe ndarja e të nxënës

Hapi përfundimtar në ciklin e menaxhimit përfshin ndarjen e mësimëve të nxënës dhe produkteve formale me audienca kyçe të brendshme dhe të jashtme. Ai gjithashtu përfshin dhënien dhe marrjen e reagimeve, kryerjen e vlerësimeve dhe auditimeve, dhe promovimin e një kulture të të nxënës. Për shkak të natyrës përsëritëse të ciklit të menaxhimit adaptiv, ky hap i fundit është gjithashtu një input i rëndësishëm për hapat e parë (ose pasues) të ciklit të projektit. Në këtë hap, është e rëndësishme të nxitet procesi i të nxënës jo vetëm brenda projektit, por edhe në nivel institucional dhe, në përgjithësi, brenda komunitetit të ruajtjes. Duke pasur parasysh këtë, këto standarde përfshijnë praktikën që organizata juaj duhet të miratojë në nivel institucional për të ndihmuar në nxitjen e të nxënës dhe ndarjes.

5A. Dokumentoni çfarë mësoni

Ndërsa kryeni procesin e përshkruar në këto standarde, duhet të siguroheni që të mbledhni dhe dokumentoni mësimet që ekipi juaj i projektit po mëson rregullisht. Mësimet mund të marrin formën e rezultateve statistikore formale ose tregime anekdotale dhe mund të përqendrohen në diçka të madhe aq sa supozimet kryesore të projektit, ose në diçka specifike si një mënyrë e re dhe e përmirësuar e ndjekjes së shpenzimeve të projektit. Ato gjithashtu mund të jenë po aq formale sa një raport me shkrim ose informale si shkrimet e shkruara me dorë, për të cilat të gjithë anëtarët e ekipit kanë të drejtë përdorimi. Aty ku teknologjia lejon, përdorimi i mjeteve online mund të jetë një mënyrë e dobishme për të siguruar që anëtarët e ekipit të mund të hyjnë dhe përditësojnë mësimet që nxënë. Një nga çelësat për ruajtjen e këtyre mësimëve është të ruani pyetjet që ju dalin gjatë procesit të menaxhimit të projektit dhe më pas përpikuni t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve kur të keni të dhënat e disponueshme për ta bërë këtë. Një tjetër çelës është të ofrohet kohë dhe stimuj për ta bërë këtë punë. Mbledhja dhe ruajtja e mësimëve të nxënës kërkon një ekuilibër mes artit dhe shkencës - dhe do të kërkojë durim dhe duke i krijuar hapësirën e nevojshme në çdo plan pune për këto detyra.

Megjithatë, në një masë të madhe, ju do t'i keni mbledhur këto mësimet në Hapin 4, bazuar në pyetjet e mësimet që keni përcaktuar. Këtu duhet të siguroheni që të dokumentoni ose regjistroni ato mësimet në mënyrë që ato të jenë në dispozicion në të ardhmen për ekipin tuaj dhe organizatën tuaj.

Produktet për këtë praktikë të standardeve përfshijnë:

- ♦ ***Dokumentimi i rezultateve kryesore dhe mësimëve të nxënës.***

5B. Ndani atë çfarë nxini

Nëse ruani atë që keni mësuar në dokumente të shkruara ose të regjistruara, do të jeni në gjendje të mbani mend nga viti në vit atë që keni bërë, çfarë ju ka ecur dhe çfarë nuk ju ka ecur, dhe çfarë planifikoni të bëni në të ardhmen. Kjo do të ndihmojë ekipin tuaj të tanishëm të projektit në një kohë të gjatë dhe do të sigurojë që stafi i ri i projektit të ketë një rekord të asaj që keni bërë dhe asaj që keni mësuar.

Nëse përdorni një softuer menaxhimi projekti si Miradi, ju mund t'i regjistroni ato komente në hapat përkatës të procesit dhe të siguroheni që ato komente të bëhen pjesë e procesverbalit historik për atë skedar projekti. Prodhuimi i dokumenteve zyrtare do t'ju ndihmojë gjithashtu të

komunikoni gjetjet tuaja tek praktikuesit në mbarë botën. Dokumentimi dhe ndarja e asaj që keni mësuar do të ndihmojë praktikuesit që punojnë në kushte të ngjashme, që merren me kërcënime të ngjashme dhe duke përdorur mjete të ngjashme për të përfituar nga sukseset tuaja dhe për të shmangur ndonjë kurth apo problem që mund të keni hasur gjatë zbatimit të projektit tuaj.

Për të krijuar dokumente të cilat do të kuptohen, do të përvetësohen dhe përdoren nga audiencia të ndryshme, duhet të kuptoni se si ata zakonisht i marrin mesazhet dhe për çfarë kanë interes të mësojnë. Megjithatë komunikimet i paraqisim si hapi i fundit i ciklit, duhet të përgatiteni për komunikimin e rezultateve tuaja dhe informacioneve të tjera relevante të projektit shumë më herët. Për shembull, në hapi 2B, ju duhet të keni identifikuar audiencën tuaj për rezultatet e monitorimit dhe se për çfarë informacioni janë ata të interesuar të kenë. Për të arritur në mënyrë efektive këto audiencia, ju nevojitet një strategji e qartë komunikimi dhe shpërndarjeje. Duhet të vendosni cilat leksione dëshironi t'i komunikoni këtyre audiencave prioritare, të përcaktoni formatin më të mirë për të arritur secilën audiencë kryesore dhe pastaj të zhvilloni dhe shpërndani produktet tuaja të komunikimit. Për shembull, ju mund të përdorni mjetet e komunikimit joformal (e-mail, thirrje telefonike) për të ndarë mësimet me audiencën tuaj të brendshme (stafi i projektit, partnerët dhe palët e tjera). Duhet që të siguronit:

- Rekomandime të qarta menaxhimi për të gjithë njerëzit e duhur bazuar në analizën tuaj;
- Hollësitë e nevojshme për të ndihmuar në interpretimin e rezultateve;
- Alternativat dhe kontigjencat e bazuara në rezultate; dhe
- Raporte të rregullta për të gjithë anëtarët e ekipit.

Për komunikimin dhe ndarjen e mësimave me audiencën tuaj të jashtme (donatorë, praktikantë të tjerë, publikë më të gjerë), ndoshta do të përdorni më shumë mjete formale të komunikimit (raporte, prezantime, video). Produktet e komunikimit mund të përfshijnë shumë forma të ndryshme duke filluar nga letrat akademike formale deri në histori dhe video. Është e rëndësishme të vlerësohet çdo produkt për të parë nëse ai komunikon në mënyrë efektive mesazhet tuaja dhe për të mësuar se çfarë mund të bëni për të përmirësuar përpjekjet e ngjashme në të ardhmen. Përsëri, monitorimi, të nxënit dhe përshtatja ndodhin në të gjitha fazat e ciklit të projektit.

Së fundmi, duhet të shikoni edhe të tjerët në komunitetin e ruajtjes si burime informacioni dhe burime mësimi për projektin tuaj. Disa nga burimet më të mira të mësimave janë përvojat e të tjerëve.

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ◆ **Identifikimi i audiencës kryesore.**
- ◆ **Hartimi i një strategjie komunikimi.**
- ◆ **Raporte të vazhdueshëm ose mënyra të tjera komunikimi për anëtarët e ekipit të projektit dhe për aktorët kryesorë të interesit.**
- ◆ **Hartimi dhe shpërndarja e produkteve të përshtatshme të komunikimit.**
- ◆ **Përdorimi i produkteve të komunikimit të personave të tjerë.**

5C. Krijoni një mjedis për të mësuar

Standardi i fundit i praktikës në cikël përfshin krijimin e një kulture performance dhe të të nxënit brenda ekipit tuaj të projektit, në të gjithë organizatën dhe partnerët tuaj dhe midis praktikuesve të ruajtjes në mbarë botën. Një kulturë performance dhe mësimi në këto nivele është e rëndësishme për të siguruar që të gjitha palët të mësojnë dhe të përfitojnë nga përvoja e ekipit tuaj. Megjithatë kjo është e shënuar si hapi i fundit, është me të vërtetë diçka që duhet ta kultivoni që nga fillimi. Për të aplikuar në mënyrë efektive këto standarde, ju duhet të punoni në një mjedis që promovon të nxënit dhe përshtatjen me kalimin e kohës. Kjo do të thotë që ju, ekipi juaj dhe organizata juaj duhet të reflektojnë vazhdimisht, të kërkojnë reagime dhe të japin reagime. Këto reagime mund të jenë formale ose joformale dhe mund të vijnë nga brenda, nga anëtarët e ekipit tuaj ose anëtarët e tjerë të stafit në organizatën tuaj. Nga ana tjetër, mund të vijnë nga mekanizma të jashtëm, siç janë vlerësimet, të cilat vlerësojnë një projekt kundrejt qëllimeve dhe objektivave të tij të deklaruar, si dhe auditet, të cilat vlerësojnë një projekt kundrejt një grup standartesh të jashtëm të procesit, siç janë ato të përshkruara në këtë dokument. Në krijimin e një mjedisi mësimor, është e rëndësishme të jesh i hapur ndaj opinioneve të jashtme që mund t'ju japin perspektiva të freskëta dhe të mprehta.

Krijimi i një mjedisi për të mësuar nuk është i lehtë. Kjo kërkon që udhëheqësit dhe donatorët të kuptojnë nevojën për rialokimin e burimeve të pakta nga veprimtaritë e menjëherëshme në punën afatgjatë të menaxhimit adaptiv. Shpesh kërkon t'u mundësojë praktikuesve të marrin disa shanse dhe të pyesin urtësinë konvencionale në lidhje me mjetet dhe strategjitë specifike të ruajtjes. Ai kërkon që ekipeve të projektit t'u jepet siguria institucionale që inovacioni dhe supozimet e ngritura vlerësohen në organizatat e tyre. Dhe kjo kërkon një angazhim për të ndarë sukseset dhe dështimet me praktikuesit e tjerë në mbarë botën - për të krijuar komunitete të vërteta të praktikës.

Produktet për këtë praktikë të standardit përfshijnë:

- ◆ *Një angazhim për të ndarë suksesin dhe dështimet me praktikuesit në mbarë botën.*
- ◆ *Reagime të vazhdueshme ndahen në mënyrë formale dhe jo formale*
- ◆ *Vlerësime dhe/ose audite në kohë të posaçme përgjatë ciklit të projektit.*
- ◆ *Liderët demonstrojnë angazhim për të nxënë dhe inovacionin.*
- ◆ *Mjedis i sigurtë për nxitjen e eksperimentimeve dhe vënien në pikëpyetje të një status quo-je.*
- ◆ *Angazhim për të ndarë suksesin dhe dështimin me praktikues të tjerë nëpër botë.*

Mbyllni qarkun

Standardet e Hapura të përshkruara në këtë dokument paraqiten në formën e një cikli. Një ekip tipik projekti mund të kalojë nëpër Hapat 1 dhe 2 mjaft shpejt (ndoshta gjatë një seminari 4-5 ditë) për të skicuar planin bazë strategjik për projektin e tyre. Ata pastaj mund të rrotullohen dhe plotësojnë detajet gjatë muajve të ardhshëm për Hapat 1 dhe 2, ndërkohë që po fillojnë gjithashtu punën e zbatimit në Hapin 3. Ekipi pastaj mund të kryejë analizat e para në Hapin 4 pas gjashtë muajsh dhe të përdorë këtë punë për të zhvilluar produktet e para të komunikimit në Hapin 5.

Siç tregohet në Figurën 1, pasi të keni përfunduar Hapin 5, shigjetat ju kthejnë në Hapin 1. Qëllimi që qëndron prapa këtij cikli nuk është që t'iu vendosë ju dhe ekipin tuaj të projektit në një qark të pafund pune. Përkundrazi, qëllimi është t'ju kujtojmë se menaxhimi adaptiv është një proces dinamik që kërkon që ju të mësoni dhe të ndryshoni vazhdimisht me kalimin e kohës. Për shembull, bazuar në analizën tuaj të të dhënave, a duhet të rishikoni vizionin dhe synimet e ruajtjes? A ka faktorë apo marrëdhënie të reja që nuk i kishit parë më parë të cilat besoni se duhet të përfshihen në modelin tuaj konceptual ose të adresohen nga një qëllim apo objektivi i caktuar? A kanë ndryshuar audiencat ose nevojat e tyre për informacion? A keni nevojë të ndryshoni planin tuaj të monitorimit? A ju duhet ta përshtasni planin tuaj operacional? Mbyllja e qarkut është duke përsëritur vazhdimisht hapat në ciklin e projektit për të përcaktuar nëse keni nevojë të shtoni ose zhvilloni më tej ndonjë prej tyre me kalimin e kohës. Është thelbi i transformimit të menaxhimit të zakonshëm në menaxhimin e vërtetë adaptiv.

Shtojca 1. Fjalorth

Ekziston një debat i pafund midis planifikuesve përse i përket kuptimit relativ të termave teknike si qëllimet, objektivat, aktivitetet, gurët e themelit, produktet dhe rezultatet. Duket se çdo zyrë, projekt, dhe individ ka grupin e tij të preferuar të termave. Nuk ka përgjigje të drejtë - gjëja më e rëndësishme është që anëtarët e ekipit tuaj të projektit dhe njerëzit me të cilët punoni, kanë një përkufizim të qartë dhe të përbashkët të çfarëdo termi që zgjidhni të përdorni.

Megjithatë me kalimin e kohës, të paturit e një fjalori standard ka avantazhe reale. Për këtë qëllim, termat teknike në këtë dokument janë përzgjedhur me kujdes, nënvizohen kur përdoren për herë të parë, përdoren vazhdimisht më pas dhe përcaktohen në këtë fjalor. Këto përkufizime bazohen në përdorimin e tanishëm nga shumë anëtarë të PMR, organizata të tjera të ruajtjes dhe planifikuesit në disiplina të tjera.

Plan Veprimi - Një përshkrim i qëllimeve, objektivave dhe strategjive të një projekti që do të ndërmerren për të zbutur kërcënimet e identifikuara dhe për të shfrytëzuar mundësitë.

Aktivitet - Një veprim specifik ose grup detyrash të ndërmarra nga stafi i projektit dhe/ose partnerët për të arritur një ose më shumë objektiv. Ndonjëherë quhet edhe veprim, ndërhyrje, përgjigje ose veprim strategjik. (Shihni lidhjen me strategjitë më poshtë.)

Menaxhim Adaptiv - Inkorporimi i një procesi formal të të nxënies në veprimtarinë e ruajtjes. Konkretisht, është integrimi i hartimit të projekteve, menaxhimit dhe monitorimit, për të siguruar një kornizë e cila teston në mënyrë sistematike supozimet, për të nxitur të nxënin dhe për të ofruar informacion në kohë për vendimet e menaxhimit.

Supozim - Supozimet kryesore të projektit janë sekuenca logjike që lidhin strategjitë e projektit me një ose më shumë targete siç pasqyrohet në një diagram të zinxhirit të rezultateve. Supozimet e tjera lidhen me faktorët të cilët mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në performancën e projektit - shih edhe faktorin e rrezikut.

Audience - Ata individë ose grupe që një ekip projekti po përpiqet të arrijë, qoftë për qëllime komunikimi ose për të ndikuar një sjellje të veçantë.

Auditim - Një vlerësim i projektit ose një programi në lidhje me një grup kriteresh të jashtëm si parimet e kontabilitetit të pranuar në përgjithësi, parimet e qëndrueshme të grumbullimit ose standardet e përshkruara në këtë dokument. Krahaso me vlerësimin.

Target i biodiversitetit - Një sinonim për termin target i ruajtjes.

Komuniteti i Praktikës - Një grup praktikuesish që ndajnë një shqetësim, një sërë problemesh, ose një pasion për një temë dhe që thellojnë njohuritë dhe ekspertizën e tyre në këtë fushë duke bashkëvepruar vazhdimisht.

Model konceptual - Një diagram që përfaqëson marrëdhëniet ndërmjet faktorëve kryesorë të identifikuar përmes analizës së situatës të cilët besohet se ndikojnë ose udhëheqin drejt një ose më shumë targeteve të ruajtjes. Një model i mirë duhet të lidhë targetet e ruajtjes me kërcënimet, mundësitë, aktorët e interesit dhe pikat kryesore të ndërhyrjes (faktorët - kërcënimet, mundësitë ose targetet - në një model konceptual ku një ekip mund të zhvillojë

strategji që do të ndikojnë këta faktorë. Gjithashtu duhet të tregojë se cilët faktorë janë më të rëndësishëm për t'u monitoruar.

Target i ruajtjes - Një element i biodiversitetit në një vend ku zbatohet, i cili mund të jetë një specie, habitat ose sistem ekologjik dhe tek i cili një projekt ka zgjedhur të përqendrohet. Të gjithë targetet në një vend duhet të përfaqësojnë kolektivisht shqetësimin e biodiversitetit në atë vend. Sinonim me termin target i biodiversitetit.

Kërcënim kritik - Kërcënimet e drejtpërdrejta të cilat janë prioritizuar si më të rëndësishmet për tu adresuar.

Kërcënimet e drejtpërdrejta - Kryesisht veprime të njeriut që degradojnë menjëherë një ose më shumë targete të ruajtjes. Për shembull, "prerja dhe transporti i drurëve" ose "peshkimi". Ato gjithashtu mund të jenë dukuri natyrore të ndryshuara nga aktivitetet njerëzore (p.sh. rritja e stuhive ekstreme për shkak të ndryshimeve klimatike). Zakonisht një kërcënim i drejtpërdrejtë lidhet me një ose më shumë grupe interesi. Ndonjëherë quhet "presion" ose "burim stresi". Krahaso me kërcënimin e tërthortë.

Forcë shtytëse (driver) - Një sinonim i termit faktor.

Kusht Mundësues - Një mundësi e gjerë ose e nivelit të lartë brenda analizës së situatës. Për shembull, korniza ligjore ose politike brenda një vendi.

Vlerësim - Një vlerësim i një projekti ose programi në lidhje me qëllimet dhe objektivat e tij të deklaruara më parë. Shikoni monitorimin dhe krahasoni me auditimin.

Faktor - Një term i përgjithshëm për një element të një modeli konceptual, duke përfshirë kërcënimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, mundësitë dhe aktorët e interesit të ndërlidhur. Shpesh është e dobishme të përdoret ky term i përgjithshëm, pasi shumë faktorë - për shembull turizmi - mund të jenë në të njëjtën kohë edhe kërcënim edhe mundësi. Gjithashtu njihet edhe me termin shkak rrënjësor ose forcë shtytëse.

Qëllim - Një deklaram formale që detajon një ndikim të dëshiruar të një projekti, siç është statusi i dëshiruar i një targeti në të ardhmen. Një qëllim i mirë plotëson këto kritere: *lidhet me targetet, i orientuar nga ndikimi që do të arrijë, i matshëm, i kufizuar në kohë dhe specifik*.

Targete të mirëqenies njerëzore - Në kontekstin e një projekti të ruajtjes, targetet e mirëqenies njerëzore fokusohen në ato komponente të mirëqenies njerëzore të prekur nga gjendja e targeteve të ruajtjes. Të gjithë targetet e mirëqenies njerëzore në një vend duhet të përfaqësojnë kolektivisht petkun e nevojave për mirëqenien njerëzore e cila varet nga targetet e ruajtjes.

Ndikim - Gjendja e dëshiruar e një targeti të ruajtjes në të ardhmen. Qëllimi është një deklaratë formale e ndikimit që dëshirojmë të shikojmë.

Indikator - Një njësi e matshme e lidhur me një nevojë për informacion specifik, siç është statusi i një targeti/faktori, ndryshimi në një kërcënim ose përparimi drejt një objekti. Një indikator i mirë plotëson këto kritere: është *i matshëm, i saktë, i qëndrueshëm dhe i ndjeshëm*.

Kërcënim i tërthortë - Një faktor i identifikuar gjatë analizës së situatës së projektit i cili është një nxitës i kërcënimeve të drejtpërdrejta. Shpesh ai përfaqëson një pikë hyrjeje për aktivitetet e ruajtjes. Për shembull, "politikat e prerjes dhe transportit të drurëve" ose "kërkesa për peshk". Ndonjëherë ai quhet shkaku rrënjësor ose shkaku themelor. Krahaso me kërcënimin e drejtpërdrejtë.

Nevoja për informacion - Diçka që një ekip projekti dhe/ose njerëz të tjerë duhet të dinë për një projekt. Baza për hartimin e një plani monitorimi.

Rezultat i ndërmjetëm - Një rezultat specifik për të cilin një projekt po punon ta arrijë në rrugën drejt përbushjes së një qëllimi përfundimtar ose objektivi (në këtë rast, fjala "i ndërmjetëm" zakonisht i referohet një dimensionit të përkohshëm).

Atribut Ekologjik Kyç (AEK) - Aspektet biologjike ose ekologjike të një targeti të cilat nëse janë të pranishme, përcaktojnë një target të shëndetshëm dhe nëse mungojnë ose ndryshohen, do të çonin në humbjen e plotë ose degradimin ekstrem të atij targeti me kalimin e kohës.

Pika Kryesore e Ndërhyrjes - Faktorët parësorë (kërcënimet, mundësitë, apo targetet) brenda një modeli konceptual mbi të cilin një ekip duhet të ndërmarrë veprime.

Pyetjet e të nxënit - Pyetje që përcaktojnë atë që dëshironi të mësoni bazuar në zbatimin e projektit tuaj. Pyetjet e të nxënit nxisin identifikimin e nevojave për informacion, dhe në këtë mënyrë, planin tuaj të monitorimit.

Korniza logjike - Një matricë e cila vjen si rezultat i një analizë të kornizës logjike që përdoret për të pasqyruar qëllimet, objektivat dhe indikatorët e projektit në formë tabelare, duke treguar logjikën e projektit.

Monitorim - Mbledhja periodike dhe vlerësimi i të dhënave në lidhje me qëllimet dhe objektivat e deklaruar të projektit. (Shumë njerëz shpesh i referohen këtij procesi si monitorim dhe vlerësim (shkurt M & E nga anglishtja)).

Plani i monitorimit - Plani për monitorimin e projektit tuaj. Ai përfshin nevojat për informacion, indikatorët dhe metodat, shkallën hapësinore dhe vendndodhjet, afatin kohor, rolet dhe përgjegjësitë për mbledhjen e të dhënave.

Metoda - Një teknikë specifike e përdorur për të mbledhur të dhëna për të matur një indikator. Një metodë e mirë duhet të plotësojë këto kritere: të jetë e saktë, e besueshme, me kosto efektive, e realizueshme dhe e përshtatshme.

Objektivi - Një deklaram formale që detajon një rezultat të dëshiruar të një projekti të tillë si zvogëlimi i një kërcënimi kritik. Një objektivi i mirë i plotëson këto kritere: orientohet sipas rezultateve, i matshëm, i kufizuar në kohë, specifik dhe praktik. Nëse projekti është konceptuar dhe hartuar mirë, realizimi i objektivave të tij duhet të çojë në përbushjen e qëllimeve të projektit dhe në fund të fundit në përbushje të vizionit të tij. Krahaso me vizionin dhe qëllimin.

Plan Operacional - Një plan që përfshin analizat e: mbështetjes financiare të nevojshme; kapacitetet njerëzore dhe aftësitë dhe burimet e tjera jofinanciare të nevojshme; vlerësimin dhe zbutjen e rrezikut; dhe vlerësimin e jetëgjatësisë dhe strategjisë përfundimtare.

Mundësi - Një faktor i identifikuar gjatë analizës së situatës së projektit i cili potencialisht ka një efekt pozitiv në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në një ose më shumë targete. Shpesh është një pikë hyrjeje për veprimet e ruajtjes. Për shembull, "kërkesa për drurë të mbledhur në mënyrë të qëndrueshme". Mund të kuptohet edhe si e kundërta e një kërcënimi.

Rezultat (outcome) - Gjendja e dëshiruar e një faktori kërcënimi ose mundësi në të ardhmen. Një objektiv është një deklaram formal i rezultatit të dëshiruar.

Praktikuesit - Të gjithë njerëzit të përfshirë në projektimin, menaxhimin dhe monitorimin e projekteve dhe programeve të ruajtjes.

Interesat prioritarë – Çfarë vlerësojnë dhe për çfarë përkujdesen në fund të fundit aktorët tuaj të interesit. Në varësi të llojit të aktorëve të interesit, këto mund të jenë targete të ruajtjes ose faktorë kontribues (kërcënime të tërthorta dhe mundësi) në një model konceptual.

Program - Një grup projektesh të cilat së bashku synojnë të arrijnë një vizion të gjerë të përbashkët. Për ta bërë më të thjeshtë, në këtë dokument përdoret termi "projekt" për të përfaqësuar si projektet ashtu edhe programet pasi këto standarde të praktikës janë hartuar për tu aplikuar në mënyrë të barabartë në të dy rastet.

Projekt - Një sërë veprimesh të ndërmarra nga një grup i caktuar praktikuesish – duke përfshirë menaxherët, kërkuesit, anëtarët e komunitetit ose aktorët e tjerë të interesit - për të arritur qëllimet dhe objektivat e përcaktuara. Përfaqëson njësinë bazë të punës së ruajtjes. Krahason me programin.

Zona e Projektit - Vendi ku ndodhet biodiversiteti për të cilin ka interes projekti. Mund të përfshijë një ose më shumë "zona ruajtjeje" ose "zona me rëndësi për biodiversitetin" siç është identifikuar përmes vlerësimeve eko rajonale. Vini re se në disa raste, aktivitetet e projektit mund të ndodhin jashtë zonës së përcaktuar të projektit.

Ekipi i Projektit - Një grup i veçantë i praktikuesve që janë përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e një projekti. Ky grup mund të përfshijë menaxherët, aktorët e interesit, kërkuesit shkencorë, stafin operacional dhe zbatuesit e tjerë kryesorë.

Rezultat (Result) - Gjendja e dëshiruar e një objektivi ose faktori në të ardhmen. Rezultatet përfshijnë *ndikimet* që lidhen me targeted, dhe *rezultatet (outcomes)* që lidhen me kërcënimet dhe mundësitë.

Zinxhiri i rezultateve - Një përshkrim grafik i supozimit thelbësor të projektit, sekuenca logjike që lidh strategjitë e projektit me një ose më shumë targete. Në terma shkencore, zinxhiri i rezultateve parashtron marrëdhënie hipotetike.

Faktor rreziku - Një kusht nën të cilin pritet që projekti të funksionojë, por i cili mund të shkaktojë probleme për projektin. Shpesh, një kusht mbi të cilin projekti nuk ka kontroll të drejtpërdrejtë. Rreziqet vrasëse janë ato të cilat kur nuk kapërcehen, e pengojnë plotësisht projektin të arrijë qëllimet dhe objektivat e tij.

Shkak rrënjësor - Sinonim për termin faktor.

Fushëveprimi - Fokusi i gjerë gjeografik ose tematik i një projekti.

Aktor interesi - Çdo individ, grup ose institucion që ka një interes të caktuar ose mund të ndikojë në burimet natyrore të zonës së projektit dhe/ose që potencialisht do të ndikohet nga aktivitetet e projektit dhe mund të ketë diçka për të fituar ose humbur nëse kushtet ndryshojnë ose qëndrojnë të njëjta. Aktorët e interesit janë të gjithë ata që duhet të merren në konsideratë për të arritur qëllimet e projektit dhe pjesëmarrja dhe mbështetja e të cilëve janë thelbësore për suksesin e tij.

Plan Strategjik - Plani i përgjithshëm për një projekt. Një plan i plotë strategjik përfshin përshkrimin e fushëveprimit, vizionit dhe targeteve të projektit; një analizë të situatës së projektit, një Plan Veprimi, një Plan Monitorimi dhe një Plan Operacional.

Strategjia - Një sërë aktiviteteve me një fokus të përbashkët që funksionojnë së bashku për të arritur qëllimet dhe objektivat specifike duke synuar pikat kryesore të ndërhyrjes, duke integruar mundësitë dhe duke zvogëluar kufizimet. Një strategji e mirë plotëson këto kritere: është *e lidhur, e fokusuar, e realizueshme dhe e përshtatshme*.

Stresi - Një aspekt i dobët i një targeti të ruajtjes që rezulton direkt ose tërthorë nga veprimtaria e njeriut (p.sh., madhësia e ulët e popullsisë, rrjedhat e reduktuara të lumenjve, shtimi i sedimentimit, ulja e nivelit dysheme të ujërave nëntokësore). Në përgjithësi stresi është ekuivalent me një atribut ekologjik kyç të degraduar (p.sh. humbja e habitatit).

Target – Shkurtim për termin Target i biodiversitetit/ruajtjes.

Detyrë - Një veprim specifik në një plan pune që kërkohet për të zbatuar aktivitetet, një Plan Monitorimi ose komponentë të tjerë të një Plani Strategjik.

Kërcënim - Një veprimtari e njeriut që degradon drejtpërdrejt ose tërthorazi një ose më shumë targete. Zakonisht lidhet me një ose më shumë aktorë interesi. Shiko gjithashtu kërcënim i drejtpërdrejtë dhe kërcënim i tërthorë.

Vizioni - Një përshkrim i gjendjes së dëshiruar ose gjendjes përfundimtare që një projekt po punon për të arritur. Një vizion i plotë mund të përfshijë një përshkrim të biodiversitetit të zonës dhe/ose një hartë të zonës së projektit si dhe një përmbledhje të deklarimit të vizionit.

Deklarim i Vizionit - Një përmbledhje e shkurtër e vizionit të projektit. Një formulim i mirë i vizionit plotëson këto kritere: është *relativisht i përgjithshëm, vizionar dhe i shkurtër*.

Plani i punës - Një plan afatshkurtër për zbatimin e një aktiviteti ose plani monitorimi. Planet e punës zakonisht rendisin detyrat e nevojshme, kush do të jetë përgjegjës për secilën detyrë, kur do të duhet të ndërmerret çdo detyrë dhe sa para dhe burime të tjera do të kërkohen.

Shtojca 2. Përkufizime dhe kritere për termat kyçe

Deklarim i Vizionit: Një formulim i përgjithshëm i gjendjes së dëshiruar ose gjendjes përfundimtare për të cilën një projekt po punon që ta arrijë.

- **Relativisht i përgjithshëm** – I përcaktuar gjerësisht për të përfshirë të gjitha aktivitetet e projektit
- **Vizionar** - frymëzues në përvijimin e ndryshimit të dëshiruar për gjendjen e targeteve ndaj të cilave projekti po punon
- **I përmbledhur** - I thjeshtë dhe i ngjeshur (përmbledhur) në mënyrë që të gjithë pjesëmarrësit e projektit të mund ta mbajnë mend atë

Qëllimi: Një deklaram formal që detajon ndikimin e dëshiruar të një projekti sikundër është gjendja e dëshiruar e një objekti në të ardhmen.

- **I lidhur me synimet** - I lidhur drejtpërdrejtë me një ose më shumë nga targetet tuaj të ruajtjes
- **Orientohet nga ndikimi** - Përfaqëson gjendjen e dëshiruar të targetit të ruajtjes në të ardhmen për një periudhë afatgjatë
- **I matshëm** - Përcaktohet në lidhje me disa shkallë standarde (numra, përqindje, fraksione, ose gjendja të gjitha/asgjë)
- **I kufizuar në kohë** - I arritshëm brenda një periudhe të caktuar kohore, përgjithësisht 10 ose më shumë vite
- **Specifik** – I përcaktuar qartë në mënyrë që të gjithë njerëzit e përfshirë në projekt t'i kuptojnë njësoj termat e përdorura në formulimin e qëllimit

Objekti: Një deklaram formal që detajon një rezultat të dëshiruar të një projekti.

- **Orientohet nga rezultatet** - Përfaqëson ndryshimet e nevojshme në kërcënimet kritike dhe faktorët e mundësive të cilët ndikojnë në një ose më shumë targete të ruajtjes ose qëllime të projektit
- **I matshëm** - Përcaktohet në lidhje me disa shkallë standarde (numra, përqindje, fraksione, ose gjendja të gjitha/asgjë)
- **I kufizuar në kohë** - I arritshëm brenda një periudhe të caktuar kohore, përgjithësisht 3-10 vjet
- **Specifik** - I përcaktuar qartë në mënyrë që të gjithë njerëzit e përfshirë në projekt t'i kuptojnë njësoj termat e përdorura në formulimin e objektivit
- **Praktik** - I arritshëm dhe i përshtatshëm brenda kontekstit të zonës së projektit dhe kontekstit politik, social dhe financiar

Strategjia: Një grup veprimesh me një fokus të përbashkët që funksionojnë së bashku për të reduktuar kërcënimet, për të përfituar nga mundësitë, ose për të rikthyer sistemet natyrore. Strategjitë përfshijnë një ose më shumë aktivitete dhe hartohen për të arritur objektiva dhe qëllime specifike.

- **E lidhur** - Ndikon drejtpërsëdrejti një ose më shumë faktorë kritikë
- **E fokusuar** - Paraqet seri specifike veprimi të cilat duhet të ndërmeren
- **E realizueshme** - E arritshme brenda burimeve dhe kufizimeve të projektit
- **E përshtatshme** - E pranueshme dhe e përputhshme brenda normave specifike kulturore, sociale dhe biologjike të vendit

Indikator: Një njësi e matshme e lidhur me një nevojë specifike për informacion, të tillë si gjendja e një targeti, ndryshimi në një kërcënim ose përparimi drejt një objekti.

- **I matshëm** - Mund të regjistrohet dhe të analizohet në terma sasiorë dhe cilësorë
- **I saktë** – Përcaktohet në të njëjtën mënyrë nga të gjithë njerëzit
- **I qendrueshëm** - Nuk ndryshon me kalimin e kohës në mënyrë që gjithmonë të masë të njëjtën gjë
- **I ndjeshëm** - Ndryshon në mënyrë proporcionale në përgjigje të ndryshimeve aktuale të gjendjes që matet

Metoda: Një teknikë specifike e përdorur për të mbledhur të dhëna për të matur një indikator.

- **E saktë** - Metoda e mbledhjes së të dhënave ka pak ose aspak kufi gabimi.
- **E besueshme** - Rezultatet vazhdimisht përsëriten - çdo herë që përdoret metoda ajo prodhon të njëjtin rezultat.
- **Kosto-efektive** - Metoda nuk kushton shumë në raport me të dhënat që prodhon dhe burimet që ka projekti.
- **E zbatueshme** - Metoda mund të zbatohet nga njerëzit në ekipin e projektit.
- **E përshtatshme** - E pranueshme dhe e përputhshme brenda normave specifike kulturore, sociale dhe biologjike të vendit

Shtojca 3. Përmbledhje e Standardeve të Praktikës dhe Produkteve

Numrat tregojnë hapat dhe nën-hapat, dhe pikat me diamant (♦) tregojnë rezultatet. Jo të gjitha standardet ose rezultatet janë të përshtatshme në të gjitha kushtet ose për të gjitha projektet, prandaj duhet të përshtateni sipas nevojës.

1. Konceptimi 1A. Përcaktimi qëllimor dhe planifikimi dhe ekipin e projektit ♦ Identifikimi i qëllimit të planifikimit dhe vendimeve. ♦ Identifikimi i vendimeve tashmë të marra dhe i kufizimeve apo limiteve. ♦ Përzgjedhja e ekipit fillestar të projektit. ♦ Identifikimi i aftësive kyçe. ♦ Identifikimi i mangësive në aftësi dhe njohuri. ♦ Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi. 1B. Përcaktimi fushëveprimin, vizionin dhe targetet e ruajtjes ♦ Përshkrim i shkurtër i fushëveprimit të projektit. ♦ Harta e zonës së projektit. ♦ Formulimi i vizionit të projektit. ♦ Përzgjedhja e targeteve të ruajtjes. ♦ Përshkrimi i statusit të secilit target prioritar të ruajtjes. 1C. Identifikimi kërcënimeve kritike ♦ Identifikimi i kërcënimeve të drejtpërdrejta. ♦ Vlerësimi ose renditja e kërcënimeve të drejtpërdrejta. 1D. Analizoni rrethanat e ruajtjes ♦ Identifikimi dhe analiza e kërcënimeve jo të drejtpërdrejta dhe e mundësive. ♦ Nëse është relevante, përzgjedhja e targeteve të mirëqenies njerëzore. ♦ Vlerësimi i aktorëve të intersit dhe interesat parësorë. ♦ Modeli fillestar konceptual. ♦ Testimi në terren dhe rishikimi i modelit. 2. Planifikimi aktivitetet tuaja dhe monitorimin 2A. Hartoni një plan formal veprimi ♦ Qëllimet për secilin target. ♦ Identifikimi i pikave kryesore të ndërhyrjes dhe draftimi i strategjive.	2B. Hartoni një plan formal monitorimi ♦ Audiencat dhe nevojat e tyre për informacion janë përcaktuar. ♦ Indikatorët dhe metodat janë përcaktuar. 2C. Hartoni një plan operacional ♦ Vlerësimi i burimeve njerëzore, financiare dhe burimeve të tjera. ♦ Vlerësimi i rrezikut dhe mitigimi. ♦ Llogaritja e jetëgjatësisë dhe strategjisë përfundimtare. 3. Zbatoni aktivitetet dhe Monitorimi 3A. Hartoni një plan pune të detajuar aftashkurtër dhe një plan kohor ♦ Një plan pune ku janë detajuar detyrat, aktivitetet dhe përgjegjëshmëritë. ♦ Një plan kohor apo kalendar i projektit. 3B. Zhvilloni dhe përmirësoni buxhetin e projektit tuaj ♦ Buxheti i projektit. ♦ Identifikohen burimet potenciale financiare. ♦ Hartohen dhe dorëzohen propozimet financiare. ♦ Sigurohen burimet financiare. 3C. Zbatoni planet tuaja ♦ Zbatimi i planit strategjik. ♦ Zbatimi i planit të punës. 4. Analizoni, Përdorni, Përshtasni 4A. Përgatisni të dhënat tuaja për analizë ♦ Zhvillimi dhe përdorimi i sistemeve për regjistrimin, magazinimin, procesimin dhe krijimin e një kopje rezervë të të dhënave të projektit. 4B. Analizoni rezultatet ♦ Analizë e rezultateve të projektit dhe supozimet. ♦ Analizë e të dhënave operationale dhe financiare. ♦ Dokumentimi i diskutimeve dhe vendimeve.	4C. Përshtasni planin tuaj strategjik ♦ Dokumentet e rishikuara të projektit (duke përfshirë planin e veprimit, planin e monitorimit, planin operacional, planin e punës dhe buxhetin). ♦ Dokumentimi i diskutimeve dhe i vendimeve të marra. 5. Ruajtja dhe ndarja e të nxëniet 5A. Dokumentoni çfarë mësoni ♦ Dokumentimi i rezultateve kryesore dhe mësimet të nxëna. 5B. Ndani atë çfarë nxini ♦ Identifikimi i audiencës kryesore. ♦ Hartimi i një strategjie komunikimi. ♦ Raporte të vazhdueshëm për anëtarët e ekipit të projektit dhe për aktorët kryesorë. ♦ Hartimi dhe shpërndarja e produkteve të komunikimit. ♦ Përdorimi i produkteve të komunikimit të personave të tjerë. 5C. Krijoni një mjedis për të mësuar ♦ Reagime të vazhdueshme ndahen në mënyrë formale dhe jo formale ♦ Vlerësime dhe/ose audite në kohë të posaçme përgjatë ciklit të projektit. ♦ Liderët demonstronjë angazhim për të nxënë dhe inovacionin. ♦ Mjedis i sigurt për nxitjen e eksperimentimeve. ♦ Angazhim për të ndarë suksesin dhe dështimin me praktikues të tjerë nëpër botë. Mbyllni qarkun
---	---	--

◆ Prioritizimi i draft strategjive. ◆ Zinxhirët e rezultateve të cilët specifikojnë supozimet për strategjitë kyçe. ◆ Objektivat për rezultatet kryesore të ndërmjetme. ◆ Strategjitë e përfunduara, zinxhirët e rezultateve dhe objektivat. ◆ Plani i veprimit i përfunduar.		
---	--	--

Shtojca 4. Shembull i aplikimit të Standardeve të Hapura në një projekt tematik

Ky shembull u zhvillua nga një grup i vogël punue për të treguar se si *Standardet e Hapura* mund të aplikohen në projekte tematike që nuk bazohen në një zonë të caktuar. Shembulli bazohet në punën e Iniciativës së Transformimit të Tregut të WWF për të adresuar kërcënimin që plantacionet e vajit të palmës paraqesin në pyjet tropikale në shumë vende, veçanërisht në Malajzi, Indonezi dhe Papua Guinea e Re.

Figura 16. Modeli konceptual i vajit të palmës me strategjitë dhe lidhjet me mirëqenien njerëzore





Figura 17. Zinxhiri i rezultateve dhe objektivat përkatëse për një strategji globale për angazhimin e industrisë në prodhimin e qëndrueshëm të vajit të palmës



Kodi	Objektivat	Indikatorët
 G1	Brenda 2013, të paktën 75% e prodhimit global të vajit të palmës përfaqësohet në anëtarësimin RSPO.	% e prodhimit global të vajit të palmës i përfaqësuar në anëtarësimin RSPO.
 G2	Brenda 2014, 50% e prodhuesve dhe shitësve të targetuar të vajit të palmës angazhohen për të prodhuar 100% vaj palme të qëndrueshëm.	% e prodhuesve dhe shitësve të targetuar të vajit të palmës të angazhuar për të siguruar 100% vaj palme të qëndrueshëm
 G3	Brenda 2015, të 20 kompanitë globale më të mira të prodhimit të vajit të palmës sigurojnë 100% vaj palme të qëndrueshëm.	# i kompanive globale të vajit të palmës që sigurojnë 100% vaj palme të qëndrueshëm
 G4	Të gjitha mbjelljet e reja prej muajit nëntor 2005 nuk kanë zëvendësuar pyllin primar ose çdo zonë e cila përmban më shumë se një vlerë ruajtje të lartë në vendet prioritare të WF (Zemra e Bornecos, etj.)	# i hektarëve të humbur të habitateve HCV si pasojë e prodhimit të vajit të palmës në zonat prioritare X, Y, Z çdo vit

Shënim: Ky zinxhir i rezultateve nuk përfshin një qëllim, sepse në këtë shkallë globale, masa përfundimtare e suksesit të kësaj strategjie është eliminimi ose reduktimi i kërcënimit të shndërrimit të pyjeve tropikale në plantacione të vajit të palmës.

PMR

Partneriteti për Masat e Ruajtjes

